

Resul Shabani është një lirik melankolik me meditim të theksuar. Poezia e tij është e mbushur me hidhërimin e vetmisë, me zgjatjen e shkurtër të lumturisë dhe madhështinë e dashurisë, me mesazhe që e kthejnë besimin në burime të pashtershme të jetës", shkruhet në motivacionin e çmimit "Dialog midis kulturave".

RESUL SHABANI: Krijuesi është rob i iluzionit të vet

Intervistoi: Bujar Hudhri

(fq. 2)



DY ANTOGJITË E STEFAN ÇAPALIKUT

nga Josif Papagjoni

(fq. 5)

Dhe dua të kujtoj një mendim të Sigmund Frojdit i cili vërente se witz-i ishte gjuhë e pavetëdijes, njësoj si ëndrrat, gabimet apo simptoma të tjera. Ai kishte, sipas filozofit, një përmbajtje të dukshme dhe një përmbajtje të fshehtë: e qeshura shkaktohet nga rishfaqja e përmbajtjeve të hequra dhe nga shmangia e frenimit shtypës.

HENRIK IBSEN PËRBALLË MAKSIM GORKIT

Si u bë poezia Zgalemi prozë poetike –
Kënga e Zgalemit apo Lajmëtarë i furtunës

Dr. Hysen Kobellari

Dituria mbarënjërzore i ngjan një muri vigan me një pafundësi gurësh të vendosur përkrah e përmbi njëri-tjetrit që, duke u parë nga larg, duket monolit e mitik, ndërsa kur i afroresh bëhet interesant, i bukur, shpirtërisht i afërt për gjithkënd e ku rrahin miliona zemra e mendime njerëzish të gjallë...

(fq. 16)

OLGA TOKARCZUK Gishti që tregon hënën

(fq. 14)



Dy recensa me mendime dhe vlerësime të kundërta për vëllimin "Sot", të F. Halitit

DITËT E SOTME NË POEZINË E NJË TË RIU

Ismail Kadare

(fq. 6)

POEZI QË S'PASQYRON TIPIKEN

nga Kapllan Resuli

(fq. 8)

RRËFIMI TRAGJIK I VETËVRASJES SË VIRGINIA WOOLF-TË

nga Hannah McKennett



BIBLIOTEKË

Jolanda Kodra

(fq. 10)

Excelsior

Afrim Demiri

(fq. 11)

Kur vetmia veton

(Libri "Lëvizja Protestante te shqiptarët: 1816–1908" i autorit David Hosaflook)

SHQIPJA E SHKRUAR – "TERRA INCOGNITA" NË FILLIMSHEKULLIN XIX

Nga Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)

Resul Shabani është një lirik melankolik me meditim të theksuar. Poezia e tij është e mbushur me hidhërimin e vetmisë, me zgjatjen e shkurtër të lumturisë dhe madhështinë e dashurisë, me mesazhe që e kthejnë besimin në burime të pashtershme të jetës”, shkruhet në motivacionin e çmimit “Dialog midis kulturave”.

Resul Shabani: Krijuesi është rob i iluzionit të vet

Intervistoi: Bujar Hudhri

Kritiku i njohur Ali Aliu shkruan diku se tërë krijimtaria e Resul Shabanit është në lidhje jetike me vendlindjen, me kujtimet e fëmijërisë: liqeni, lumi (Drini) dhe fshati juaj, Kalisht, buzë gjolit. Në vendlindje keni kryer deri edhe shkollën e mesme. Besoj, këtu, *buzë liqerit*, keni nisur të shkruani vjershat e para.

Akademiku Ali Aliu është njohësi më i mirë i krijimtarisë sime, por, në të njëjtën kohë, është edhe njohësi më i mirë i poezisë bashkëkohore shqiptare. Është lexues aq i vëmendshëm i saj, sa të impresionon, kur ke parasysh edhe moshën e tij (86 vjeç). Profesori ka shumë të drejtë dhe këtë konstatim të tij e përforcojnë edhe mendimet e Luan Starovës, Zija Çelës, Visar Zhitit, Ahmet Selmanit, e të ndonjë tjetri. Frymëzimin magjik të muzave, qetësinë shpirtërore, çlodhjen fizike, e gjej vetëm në Kalishtin buzë gjolit margaritar të Ohrit, Poradecit e Strugës. Kalishti dhe Struga më janë imponuar aq fuqishëm, sa që u bënë emra toponimikë që u lidhën në mënyrë të pashmangshme me emrin e krijuesit. “Një mal si Kilimanxharo na sjell ndër mend Heminguejin, ashtu si Makondoja na kujton Markezin, Korça pikturat e Mios, Shkodra Fishtë, Koliqin e Migjenin. Janë emra të mëdhenj dhe, natyrisht, nuk i sjellim për ndonjë familjarizim, por për të përmendur sado shkarazi se çfarë fuqie ka arti dhe ç’nder u takon artistëve” (Zija Çela). Hamendësimi juaj se këtu zë fill krijimtaria ime, është i saktë. Më 1963 kam shkruar dhe botuar në gazetën “Flaka e vëllazërimit” të Shkupit tregimin e parë, *Bamirësia*, që flet për gjestin e një fëmije i cili zgjon nga gjumi një pushues breg liqenit, pasi kujtonte se kërcënohej nga kafshimi i gjarprit. Atëherë nuk e kam ditur se gjarpri i ujit nuk është helmues. Historia e letërsisë ka dëshmuar se fëmijëria është shoqëruesja më besnike e autorit. Është si lëkura e trupit. As vetë s’e di se sa poezi e tregime kam shkruar për vendlindjen time. Ajo është: *...mjafton njëherë me shigjetë/ të më ther*

në zemër/ dashuria për Ty/ që ke ujin e kulluar/ që ke malin e gjelbëruar/ që ke tokën pjellore/ që ke qiellin mbi kokë/ që ke arteret e jetës/ dhe oxhakun e lartë/ – këto më bëjnë ilaç/ o vend-lindja ime .

Keni qenë student në Shkup së pari, pastaj keni vazhduar në Prishtinë. Ishit me fat, besoj, se në atë kohë Prishtina ishte kthyer në një qendër të rëndësishme kulturore. Çfarë do të veçonit nga jeta studentore në Prishtinë?

Pasi mbarova Akademinë Pedagogjike për gjuhë

dhe letërsi shqipe dhe maqedonase në Shkup, vazhdova studimet në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Filozofik. Në Shkup kishim vetëm tri-katër lëndë në gjuhën shqipe, ashtu siç i kishim të pakta edhe në gjimnazin e Strugës, për këtë arsye, në janar të vitit 1964, klasa jonë bëri një protestë duke kërkuar profesorë shqiptarë.

Për ne shqiptarët që jetonim në Maqedoni, Prishtina ishte Qabeja dhe Jerusalemi ynë. Ishte shpresa dhe siguria (edhe imagjinare) jonë. Ishte vatra e arsimit, panteoni i kulturës që rrezatonte sadopak edhe përtej kufirit administrativ të kohës. Ishte një përparësi e madhe qarkullimi i lirë i njerëzve, mallrave dhe ideve. Ishim një shtet. Studentët shqiptarë që vinin nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës, në Prishtinë gjetën dorën e ngrohtë të zgjatur të autoriteteve qeveritare, të institucioneve dhe kosovarëve. Gjetën ambientin frymëzues patriotik, gjetën kulturën dhe shkencën kombëtare. Shumica syresh u kthyen nga kishin ardhur për të shpërndarë ato rreze dije e drite. Një pjesë tjetër, krijuan familje atje dhe mbetën. Atë që bëri Prishtina ato vite të vështira për ne (se në vendlindjet tona mbretëronte një atmosferë politike ngulfatëse), nuk e bëri Tirana zyrtare as atëherë as sot. Në kuadër të universitetit vepronte edhe grupi letrar, ku ishin të anëtarësuar talentet e reja, si Teki Dervishi, Musa Ramadani, Beqir Musliu, Eqrem Basha, Ymer Shkreli, Milazim Krasniqi, Abdullah Konushevi, Hasan Hasani, Nexhat Halimi, unë, e shumë të tjerë. Ishte kjo edhe bërthama e brezit të artë të letërsisë shqipe në këto anë, bashkë me Ali Podrimjen, Sabri Hamitin, Ibrahim Rugovën, Zejnullah Rrahmanin, Mehmet Krajën, ishte brezi që iu kundërvu metodës socrealiste, e cila përkrahej (me botime) nga Tirana. E ne na kishte shpallur për dekadentë.

Kur u kthyet në vitin 1971 në Shkup, filluat punë në gazetën “Flaka e vëllazërimit” (revistat “Jehona”, “Gëzimi”, redaksia e librit artistik), të cilat dhanë një kontribut të madh për kulturën shqiptare në Maqedoni. Si ka ndikuar te ju si autor kjo periudhë?

Gazeta “Flaka e vëllazërimit” atëherë filloi të dilte tri herë në javë, prandaj dhe kishte nevojë për gazetarë. Me sugjerimin e disa shokëve, unë duhej të kthehesha në Shkup për të kontribuar me aq sa mundnim. Dalëngadalë, numri i gazetarëve po shtoej dhe ne po bëheshim të dobishëm. “Flaka e vëllazërimit” ishte një njësi punuese në kuadër të një sipërmarrjeje të madhe, “Nova Makedonija”. Në gjirin e saj “Flaka...” kishte edhe revistat për fëmijë “Gëzimi” dhe “Fatosi”, revistën për çështje artistike, kulturore dhe shkencore “Jehona” (10 numra në vit) dhe redaksinë e botimit të librit artistik, themeluar nga Ali Aliu më 1971, i cili ishte larguar në Prishtinë. Për shqiptarët në Maqedoni kjo përbënte një qendër informative, kulturore, artistike dhe shkencore, duke dhënë kështu një kontribut të jashtëzakonshëm në emancipimin e popullatës shqiptare. Gazeta pasqyronte jetën e shqiptarëve (me kufizimet e imponuara politike) me të gjitha problematikat e saj. Ka pasur edhe periudha shumë të vështira, kur duhej t’i thoshe të zezës e bardhë apo, si thotë populli, derri - dajë. Në faqet e gazetës defiluan gati të gjitha penat gazetareske dhe letrare të shqiptarëve. Në periudha të caktuara, “Flaka...” botonte edhe autorë nga Kosova, të cilët kishin rënë ndesh me politikën e atjeshme. Gjithashtu, ka botuar edhe autorë nga Republika e Shqipërisë, gjë të cilën nuk e bënte ajo për ne. Në Shkup shkrova dhe botova shumicën e veprave të mia. Një pjesë i kam botuar në Prishtinë dhe disa tek Onufri në Tiranë, që është i vetmi botues me karakter mbarëkombëtar, duke zëvendësuar neglizhencën e Ministrisë së Kulturës. Vështirësitë kanë qenë të shumta, si në aspektin e kushteve (pa kohë dhe komoditet të mjaftueshëm), nën trysninë e censurës dhe sidomos, autocensurës.

RESUL SHABANI

Dashuria e kapitenit





Gjuha e Ezopit dhe aluzionit na ishin bërë “veglat” më të domosdoshme të punës.

Ndryshe nga ç’mund të pritej normalisht, libri juaj i parë, *Liqeni* (1974), është një vëllim me tregime dhe jo me poezi. Është kjo një rastësi?

Jo, s’është rastësi. Poezitë kanë ardhur pas tregimeve. Nuk them se ka ndikuar tregu, por është fakt se redaksitë i kërkonin më shumë tregimet, meqë proza ka qenë gjithmonë më deficitare. Ashtu më kanë ardhur.

Më pas vijoni me dy vëllimet e para me poezi dhe në vitin 1982 botoni në “Rilindja” të Prishtinës librin *Anija e vjetër*, që përmbante dy drama. A mund të na shpjegoni se si bëni që kaloni nga njëra gjini tek tjetra dhe a keni një ide se ku jeni më i realizuar (ndiheni më mirë)?

Shkrimtari është rob i iluzioneve të veta. Poezia shpesh lind si ngacmim i çastit, që të trazon dhe shtendosesh kur e nxjerr në letër. Poezisë i mjafton motivi, kurse proza kërkon temën. Ndodh rrallë që t’i thuash vetes: Do të ulem të shkruaj një poezi! Por kur shqetësimi bëhet i padurueshëm, torturues për shpirtin, si dhimbja e dhëmbit për trupin, e shkruan. Me tregimin, që s’është e thënë të ketë një ngjarje të madhe, por mjafton atmosfera, ndodh pak më ndryshe. Lindja e tij pret pak më tepër. Ndërsa me romanin, e sidomos me dramën, ku me patjetër ka një ngjarje të shtrirë; ka personazhe me karaktere të ndryshme; ke intrigën dhe kërkohet zgjidhja e saj; të kërkohen edhe fakte historike; përgatit një sinopsis, e ndan lëndën në pjesë ose kapituj etj., etj., pra bën parapërgatitje, bën sistemin e lëndës. Te proza nuk të mjafton vokacioni prej krijuesi, siç ndodh me poezinë. Proza krijuesin pa talent, të papërgatitur, pa kulturë, e nxjerr zbuluar. Diversioni dhe kamuflimi është i pamundshëm. Edhe këtu, si në poezi, autori është rob i iluzioneve. Edhe pse është shumë i sigurt se me veprën e tij ai nuk ndryshon asgjë në shoqëri, – as ndikon në vendimet e qeverive, as të ministrive, as të prokurorive, as të gjykatave, as të bankave, as të akademive etj., – ai përsëri ngulmon të shkruajë e të botojë, duke shpresuar se njëherë do të merret seriozisht. Gjë që s’ndodh. Ai kurrë nuk vendos

për fatin e të tjerëve, por gjithmonë ndodh e kundërta. Autori nga qarqet vendimmarrëse trajtohet si lolo, qesëndiset. Mjafton t’u hidhet një sy fateve të jetëve të tyre, të pozitave të tyre shoqërore. Nëntëdhjetë e pesë për qind e tyre vuajnë edhe për bukë e ilaçe, por nuk ndodh që një ministër apo deputet ta përfjetojë këtë fatkeqësi. Megjithatë, krijuesi vazhdon të mbetet peng i këtyre iluzioneve që, në shikim të parë, i duken të ëmbla e të dobishme. Nga ky rregull nuk bëj përjashtim as unë. P.sh., më 1965 botova në gazetë (3 vjet më vonë te libri *Hamleti me plis të zi*) poezinë *Diçka po ndodh në skenë*. Po citoj 3-4 vargje me helm për sistemin e kohës: *...Përse nuk ngrihemi e të shohim se ç’ndodh?/ Të dalim edhe ne njëherë në skenë!/ Dhe aktorët që na lodhën me fjalë/ Le të ulen e të na dëgjojnë.../ T’ia marrim shtruar edhe njëherë edhe ne/ Le të dalë, ku të dalë, le të na prishet hekuri./* Më vonë botova dramën *Shi në Uertomonto* (1979 në revistë dhe më 1982 si libër), një dramë kundër dhunës së pushtetit mbi krijuesin, mbi individin. M’u desh ta “shpërngul” ngjarjen në Kili,


se gjoja po kritikoj diktatorin Pinoçet dhe po mbroj Pablo Nerudën; në fakt, i sulesha çiftit diktatorial Tito-Enver. Drama u inskenua nga regjisori Vladimir Milçin (prisja rrëmujë, prandaj insistova që regjisori të jetë maqedonas). U bë një shfaqje-film. Mori disa çmime në Festivalin Federativ të Sarajevës (1986). Ç’ndodhi? Asgjë! Qeverisë dhe partisë nuk i interesoi. Vetëm unë flija si lepur, duke pritur policinë të më arrestojë. As kjo nuk ndodhi! Dhe tani lexuesi mund të pyesë: Po përse shkrimtari vazhdon të shkruajë? Sipas meje, përgjigja është kjo: Iluzioni është më ngjites se duhani, se pija, se kumari, se droga... Është mallkim perëndie. Edhe kur autori zhgënjehet tmerrësisht, në një skutë të shpirtit gjallon shpresa se me veprën e tij do të ndryshojë diçka. Më në fund, mjaftohet nëse me krijimin e tij ka fisnikëruar sadopak shpirtin e egërsuar të akëcilit lexues. Ai bindet se kaq është fuqia e artit, këtë përkufizim ka misioni i tij. Dhe kjo nuk është pak.

***Dashuria e kapitenit* është një roman i suksesshëm, i botuar tetë herë (dy herë tek Onufri), i përkthyer dhe i përfshirë edhe në programet shkollore. Si ka ndikuar në krejt krijimtarinë dhe emrin tuaj si autor?**

Është një roman që flet për koncepte dhe filozofi të ndryshme mbi luftën. Është konflikti midis një profesori, i cili mendon se lufta për çlirim (të Strugës) bëhet kudo qoftë dhe me disa mjete, dhe kapitenit (oficer i ushtrisë së Mbretit), që mendon se lufta duhet të bëhet vetëm në Strugë. Përshkruhen edhe fatet e bashkëpunëtorëve të okupatorit dhe të asnjansëve. I kam rënë edhe segmentit intim: raportit bashkëshortor, duke dashur të vë në spikamë një tabu, se dashuria përfunduaka me martesën. Romani u prit shumë mirë. Dy herë është përfshirë në programet shkollore, këtu. Ma ka rritur namin! Romani u dramatizua dhe u vu në skenë nga regjisori vlonjat Armando Bora.

Çdo verë, në anën tjetër të liqenit, në kullën e tij, jashtë vëmendjes së të gjithëve, jetonte liriku i madh i poezisë shqipe, Lasgushi. Si e keni ndier në jetën dhe veprën tuaj këtë poet?

Unë vdes t’i ngjasoj Lasgushit në gjithçka. Nuk e fsheh që e kam idhull. Këtë e kanë vërejtur edhe





miqtë e mi krijues. P.sh., duke shkruar për tregimet e mia, romansieri i veçantë Zija Çela thotë: “Nuk e kisha ditur se Nositi i pakthyesëm i poezisë shqipe, Lasgushi tempullar, kishte lënë në bregun tjetër, karshi Poradecit, një nxënës të ndjeshëm, një prozator lirik, që i këndonte liqenit deri në atë shkallë e përkushtim, sa ta identifikonte gjithashtu me vetveten.” Natyrisht që ky vlerësim më bën krenar. Edhe me sjelljen në jetë përpiqem t’i ngjasoj. Dikush mund të më akuzojë për epigonizëm. Punë e madhe! Më pëlqen. Kështu veproj edhe me daljen time publike. Jam shumë i kursyer. Nuk më pëlqen të dal. Në raste të tilla, e thirr për arsyetim sjelljen e Lasgushit. Pyes veten: A do të dilte Lasgushi? Jo. Çfarë humbi ai që s’doli me dekada? Asgjë. Atëherë? Lëshoje teposhtë! Më 1993-94, me botuesin Fahri Balliu, atëherë diplomat në Shkup, shkuam në Poradec. Desha ta shoh, të paktën, shtëpinë e Lasgushit. Vajtëm. Ç’të shohësh?! Një gjysmë rrënoje. Na del pronari, i cili në oborrin e kësaj shtëpie po ndërtonte një vilë, dhe na pyet se ç’kërkojmë. I thamë: Përse nuk e rindërton shtëpinë e poetit (e kishte blerë për 4000 dollarë, me sa mbaj mend), por ndërton vilë? Do ta bëj muze që të çuditëni, na tha. Akoma po bëhet! Më 2012 shkrova dhe botova poezinë *Përsiatje tri ditë para vjeshte*. Poezia brenda vitit u ribotua 14 herë. Një regjisore strugane më tha: Z. Resul, ma përkujton Lasgushin. Unë u mburra, nuk u preka.

Shumë nga librat tuaj janë përkthyer në disa gjuhë të ndryshme. Jeni ndër të paktët shkrimtarë shqiptarë i pranuar në shkallë shtetërore dhe kombëtare. Keni marrë çmime të rëndësishme kombëtare etj. Çfarë do të veçonit me këtë rast?

Ashtu qoftë! Çmimet në një moshë më të re edhe mund të stimulojnë krijimtarinë e autorit, por në moshën më të shtyrë vetëm sa përkëdhelin sedrën e tij. Zakonisht, çmimet vijnë vonë. Më në fund, edhe ato në njëfarë mënyre dëshmojnë për vlerat e veprës. Janë një mirënjohje e vakët. Në shoqërinë tonë çmimet nuk

shoqërohen me ndonjë sasi mjetesh financiare, sa të të zgjidhin një hall. Më në fund, janë të mirëseardhur. Kryesorja, të jenë të merituar. Nuk e di kush e ka thënë se “autori të mos bëjë asgjë (të pahijshme) për ta marrë një çmim, por, kur i jepet, duhet ta pranojë”. Jam udhëhequr nga ky parim dhe kam marrë mbase rreth 15 çmime, por asnjë nga institucionet zyrtare të Tiranës.

Do të veçoja kontributin tuaj të madh në promovimin e letërsisë shqiptare në Maqedoni. Janë dhjetëra shkrimtarë nga Tirana që ju i keni botuar, i keni promovuar dhe i keni ftuar në festivale të ndryshme letrare. Sidomos, në aktivitetin e rëndësishëm dhe dinjitoz “Netët strugane të poezisë”, kur ishit në komitetin organizator. E di shumë mirë këtë, se e keni bërë me pasion, me dashuri, por edhe për një dialog mes fqinjësh. Çfarë mbresash ju kanë ngelur në zemër dhe mendje më tepër?

Gjithmonë në jetë jam udhëhequr nga parimi: Përpiqu të ndryshosh për mirë gjendjen që ke gjetur; përpiqu të lësh gjurmën tënde, përndryshe, mos prano post e pozitë, mos merr përgjegjësi. Në këtë vazhde më duhet t’i them dy-tri fjalë. Më 1976, kur u emërova redaktor përgjegjës i revistës “Jehona” dhe i redaksisë së botimeve letrare, këto i gjeta në një gjendje jo të lakmueshme. Revista dilte me dy-tri vëllime në vit dhe libra botoheshin 3-4. Deri më 1979, kur m’u desh “vullnetarisht” të jap dorëheqjen, pasi në edicionin e botimeve kisha botuar librin me poezi *Shenjat e shenjta* të poetit, përkthyesit e veprimtarit Jusuf Gërvalla, i cili në dhjetor të atij viti u arratis në Gjermani, revista dilte 8-10 numra në vit, me faqe të shtuara, kurse botimet arritën deri në 23 tituj. Kështu u solla edhe kur isha anëtar i Këshillit Drejtues të Festivalit të Strugës. Ndikova që të rritet numri i poetëve shqiptarë nga të gjitha trojet. Në kuadër të Festivalit përktheva dhe botova poetin Fatos Arapi, që më vonë u bë edhe laureat

i çmimit “Kurora poetike”. Më 1996 u organizua Nata e Poezisë së Shqipërisë (e Kosovës kishte ndodhur vite më parë). Ishte një natë magjike. Me poetët Bardhyl Londo, Xhevahir Spahiu, Ndoc Gjetja, Andi Bejtja, Jorgo Bllaci. Me aktorët Yllka Mujo e Bajrush Mjaku. Ishte mbrëmja e vizituar e festivalit. Në këtë kuadër, u botua edhe *Antologjia e poezisë shqipe*, me autor Ali Aliun.

Po. më kujtohet që mbrëmja u çel me këngën *Mora rrugën për Janinë*. A mund të na tregoni më shumë për këtë ngjarje të bukur?

Meqë përgjigjja nga Tirana po vonohej, e binda drejtorin e Festivalit, z. Paskal Gilevski, se duhet të shkojmë në Tiranë për t’ua dorëzuar ftesën në dorë, meqenëse ishte dhe 35-vjetori i Festivalit. Shkuam, biseduam me London dhe Spahiu (kryetarin dhe sekretarin e Lidhjes). Ata na ofruan që të rrimë dy net. Ditën e pushimit vajtëm në Berat, të shoqëruar nga poeti e përkthyesi Jorgo Bllaci, drejtor i shtëpisë botuese “Naim Frashëri” atë kohë. Rrugës në makinë shoferi kishte lëshuar muzikë. Aty e dëgjuam edhe këngën *Mora rrugën për Janinë*. Drejtorit i pëlqeu dhe u bë.

Këtë parim kam ndjekur edhe kur kam qenë anëtar i Kryesisë së PEN Qendrës së Shkupit, duke pranuar për çdo vit nga një anëtar shqiptar. Pastaj gjatë konferencave të tij në Ohër bëra çmos, bashkë me poeten dhe përkthyesen Entela Safeti, për aktivizimin e PEN Qendrave të Kosovës dhe të Shqipërisë. Edhe si anëtar i Kryesisë së Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë kam ndikuar që të pranohet çdo vit nga një anëtar shqiptar, të themelohet çmimi për autor jomaqedonas *Ura letrare* (fituese e parë u bë shkrimtarja e talentuar Delvina Kërluku) dhe që çmimin *Skeptri letrar* ta marrin poetët Sadik Bejko dhe Eqrem Basha. Pastaj edhe Arian Leka. Kjo s’do të thotë se kushedi çfarë kam bërë, por desha ta dëshmoj rolin e individit në situata vendimmarrëse.

Nga ana tjetër, jam i sigurt se edhe kultura maqedonase duhet t’ju jetë mirënjohëse për dhjetëra autorët e tyre që i keni sjellë në shqip, duke kulmuar me *Antologjinë e poezisë maqedonase*. Njerëz si ju janë kaq të nevojshëm sot në Ballkan, për të njohur dhe për të kuptuar më mirë njëri-tjetrin nëpërmjet kulturës, ku libri është kryesori. Nga përvoja juaj, si mund të çohen më përpara bashkëpunime të tilla?

Për t’i shtyrë punët përpara duhet vullnet, dëshirë, këmbëngulje, disponim pozitiv. Jo gjithmonë institucionet dhe individët e kanë këtë predispozitë. Nga kjo vuajnë kulturat dhe shoqëritë. Për fat të keq, në këto raporte më zvarranike ka qenë pala shqiptare. Ajo as boton libra, as organizon festivale, as fton krijues, as... S’e kuptoj dot. Të gjitha qeveritë përreth interesohen për pjesët e popullit të vet në shtetet e tjera, përveç Shqipërisë. P.sh., Ministria e Kulturës e Maqedonisë financon gazeta e libra të maqedonasve që botohen edhe në Australi. Kështu vepron edhe qeveria turke, greke, serbe, bullgare etj., kurse ministria shqiptare nuk mbahet mend të ketë ndarë gjysmë leku për botimin e librave tanë, për promovimin e vlerave tona.

Tani jeni kthyer në Kalisht, tek “e vjetra shtëpi bregliqenore”. Jeni kthyer te fëmijëria juaj dhe ju përfytyroj me Lirikon dhe Lirianin, nipat tuaj të dashur, bregut të liqenit, aty ku Drini nis udhën për në Shqipëri. Por nuk e marr me mend se ç’ndieni, nuk e di se çfarë bëni konkretisht pas gjithë kësaj jete intensive: poezi, tregime, dramë, gazetari, po përktheni, mbase po shkruani kujtimet?

Krijimi kalon përmes meditim. Kujtimet i presin të gjithë. Liriku e Liriani mezi e presin Panairin e Librit për ta parë Tiranën. I ka marrë malli për sheshin *Skënderbej*.

DY ANTOGJITË E STEFAN ÇAPALIKUT

nga Josif Papagjoni

Stefan Çapaliku e ka bërë zakon që çdo botim të ma sjellë dhe më pas kërkon një mendim. Kështu bëri edhe kësaj here, në këtë kohë pandemie, me dy librat e tij të fundit, format xhepi: 1) Një antologji e vogël e jetës, 2) Një antologji e vogël e vdekjes (Botimet Fishta, 2020). Kësaj radhe po them disa fjalë për librin e parë. Ndoshta sepse Stefani është një “qeçfli” i njohur barsoletash, që ndrit nëpër tavolina miqsh e fiton vezullimin e njeriut që gazmon veten dhe miqtë, që krijon gjithkund simpati. Edhe dramaturgjia e tij ka shumë humor të tipit të “barsoletës”, pra një lloj “salce” e përdorur me frytshmëri, përfshi posaçërisht befasitë humoristike, replikat e mprehta, fundet e papritura. E para gjë që duhet ta them menjëherë është fakti se ky libër është libri i parë në historinë e letrave shqipe, që bën objekt këtë lloj të shkurtër të komikes, barsoletën. “Barsoleta është një formë humorit që vjen dhe shkon bashkë me lindjen dhe vdekjen e një civilizimi”, - përcakton Çapaliku. - “Ajo është një shpërthim verbal sintetik, me rrënjë të ngulura thellë në një moment të zhvillimit të shoqërisë dhe me karakteristika po kaq të qarta historike”. Dhe në voli të këtij argumenti ai sjell citime e ide nga filozofë dhe estetë të njohur të botës, si Bergson (nga libri i tij “E qeshura”, përkthyer edhe në shqip më 2015), Sigmund Frojd, Holt Jim, Ben Lewis, Marks, Robert Provine, Lazar Sheresgowsky, Maria Todorova etj.

Në fjalorët terminologjikë të estetikës së humorit barsoleta, si lloj i shkurtër e telegrafik, në gjuhë të ndryshme ka edhe emërtime të ndryshme, si, bie fjala, në rusisht ajo quhet “anekdot” apo “shutka”, në gjuhët latine vijon në versione të ndryshme të termit, në gjuhën italiane “barzelleta”, në anglisht njihet si “joke”, ndërsa në gjermanisht, çka ka fituar edhe një përdorim simptomatik në optikën teorike estetike, quhet witz. Cituar sipas Gustav Rene Hocke-it, në librin *Manierizmi në letërsi*, ASMUS, witz-i (blague, witt, barzelletta) është një formë rrëfenje apo gjëze, përgjithësisht shumë e shkurtër, që krijon një situatë komike të papritur. Edhe në kuptimin e sotëm ajo shfaqet si një tekst i shkurtër (rrëfenjë, bisedë, pyetje-përgjigje etj.), që krejt papritur kalon nga një gjendje tek tjetra. Ndryshimi i përnjëhershëm i pozicionit quhet Pointe. Çapaliku vërteton te libri i tij se ky lloj i shkurtër i humorit, i njohur, pra, më së shumti me emrin “barzellete” apo “anekdotë”, ka qenë i pranishëm gjithkund në jetën artistike të estradave shqiptare. Ato janë shfrytëzuar si shkarkesa të dobishme psikologjike në kushte trysnie politike gjatë periudhës së diktaturës, sa dhe në kushte të jetës aktive të njerëzve, në raste gëzimesh, tubimesh, tavolinash, festash miqësore, ritualesh festive etj. Të katërta emërtimet

e mësipërme të këtij lloji të shkurtër (“telegrafik”) të dramaturgjisë me objekt komiken, humorin, janë ndërvepruese me pritësin masiv në krijimin e medimeve sociale të shëndetshme. Nga ana tjetër, barsoletat përsëriten shpesh e më shpesh dhe krijojnë qindra invariante, pasi funksionojnë si letërsia gojore dhe ruajnë parimet e kulturës folklorike popullore, ku “krijuesi i parë” e humbet autorësinë dhe ai bëhet “kolektiv”. Çapaliku nuk merret aq teorikisht me argumentin dhe as i mëshon atij, sepse e identifikon qerthullin e barsoletës përjashtimisht në qytetin e Shkodrës, me të cilin përherë rreket të identifikohet dhe të shpërfaqet si bard i saj dhe një “shkodran i thekur”. Çdokush ka një mall, një “plagë”, një merak, një peng, që e mban mbi shpinë; a një “dashnore”, falë së cilës mallëngjehet dhe na mallëngjen. Njësoj bën edhe dramaturgu i njohur me qytetin e tij të lindjes. Kjo s’prish punë. Por unë do të doja vetëm t’i thosha mikut tim se tema është mjaft interesante në vetvete, krejt e parratur dhe e pashkelur në studimet tona letrare e antropologjike. Mua për vete më intrigon shumë. Do të ishte një ndihmesë e vyer, doemos e munguar, me patjetër meritore, që ai ta lëvronte më tutje, pra edhe si një studim të thelluar nesër në rrafshet sa letrare, estetike, aq dhe antropologjike. Por sot kemi këtë qasje dhe lipset, pra, të flasim përjashtimisht për atë. Dua të sjell në mendje këtu një ide-sintezë të Novalis, i cili përcakton se barsoleta apo witz-i është pjesë dhe gjendje e “elektricitetit të shpirtit...” Vërtet unë kam qeshur mjaft me barsoletat që Stefani ka sjellë në faqet e librit të tij. Dhe dua të kujtoj një mendim të Sigmund Frojdit i cili vërente se witz-i ishte gjuhë e pavetëdijes, njësoj si ëndrrat, gabimet apo simptoma të tjera. Ai kishte, sipas filozofit, një përmbajtje të dukshme dhe një përmbajtje të fshehtë: e qeshura shkaktohet nga rishfaqja e përmbajtjeve të hequra dhe nga shmangia e frenimit shtypës.

S. Çapaliku na bën me dije se barsoletat kanë qenë përherë një premisë gëzimi mes njerëzve, kanë krijuar atmosferë gazmore në meset sociale, duke kontribuar në shëndetin e shoqërisë edhe në periudha të rënda si ajo para vitit 1990. Përveç meseve sociale, edhe në skenat e estradave shqiptare, megjithëse jo të shpeshta, pasi quheshin “humor i lehtë”, pa peshë, joproblematik, përkundrazi anekdotat, barsoletat, grimcat humoristike, epigramet fituan hapësirë gjithnjë e më të lakmuar e të mirëpritur te publiku i gjerë, posaçërisht në vitet ’80, duke ofruar një gjuhë më të shpenguar e më të shkathët në bërjen e humorit dhe duke shmangur retorizmin dhe skematizmin e rëndë tashmë ngufatës e asfiksues. Siç bën me dije autori, kjo gjini pak e pranishme në

skenat dhe ekranin e televizorit (të vetëm shqiptar TVSH), pas viteve ’90 pati një përdorim të gjerë, si për të “shfryrë” dufin e mbledhur nëpër vite nga shtypja dhe ndalesat dhe për ta “institucionalizuar” më në fund atë, sidomos në edicionet televizive humoristike.

Duke e këqyrur lëndën e librit, teksa lexoja barsoletat e përzgjedhura nga Çapaliku, më duhet ta them se qeshja shpesh me veten dhe ndieja kënaqësinë e “shkrepejeve” dhe “befasive” të këndshme që ato më jepnin. Por unë e di se në tavolina, barsoletat provokojnë humor shumë më brufullues, pasi janë tri faktorë që e mundësojnë këtë, siç vëren dhe autori: a) bashkësia e njerëzve, b) mediumi receptiv e ritualistik (banket, festë, dasmë, gëzim familjar, shoqëror, “sebe”) dhe c) aftësia e atij që tregon (narratorit). Çapaliku është vetë një nga “mjeshtërit” e njohur të rrëfimit të barsoletave. Madje, ndonjëherë, ai krijon ndonjë personazh pranues mes miqsh dhe i atribuon atij një mori barsoletash, si p.sh. “ka thanë X-Y”, ose “ja ç’i paska ndodhur njëherë X-Y”. Është me interes të thuhet se pavarësisht vëllimit të vogël shkrimor, në rastet e gjetjeve të mprehta te gazmoret, anekdotat, barsoletat, grimcat humoristike, epigramet e shumta, ato bëhen tejet interesante, me funde të befta që shkaktojnë menjëherë një humor të shpenguar, të lirë. Shpeshherë në këto lloje të shkurtra të humorit aplikohen fillimisht ekspozitë si të “zgjatura”, të cilat krijojnë trysninë e nevojshme dhe suspansin, ndërsa mbyllja është e menjëhershme, me një batutë të bukur dhe shumë të mprehtë, që nuk të shkon në mendje, që ka në rrënjë të vet një kundërshti të shfaqur haptazi dhe befasisht, duke vijuar me një ide të mprehtë, më së shumti me natyrë pozitive e dashamirëse, sikurse dhe me identifikimin e një problemi, çështjeje apo argumenti të mprehtë.

Në librin e tij *Një antologji e vogël e jetës* e shkrimtarit dhe studiuesit Stefan Çapaliku flitet pikërisht për barsoletën në Shqipëri, duke u ndalur kryesisht tek ato që kultivoheshin dendur në qytetin e njohur të humorit, Shkodër. Humori i këtij tipi është një manierë e përshtatur në mënyrë arbitrare. Pikërisht tek “arbitrarja”, siç thoshte Kanti, qëndron edhe ajo që tek witz-i është pikante. Prandaj edhe filozofi do ta cilësonte shkurt këtë lloj letrar të humorit me fjalët: “Arsyeja është sublime, “witz”-i është i bukur”. Me fjalë të tjera, paçka se barsoleta apo witz-i nuk mbërrinte dot në lartësinë dhe “dinjitetin” e arsyes teorike, ai ishte mjaft tërheqës

dhe pasoja që sillte shoqërohej me një ngazëllim kolektiv; kjo falë bukurisë së tij, mendjemprehtësisë, befasisë, lojës së mendjes në vrapin e të papriturave, shkathtësisë lojcake të mendjes që sa të huton, aq dhe të jep gjithë kënaqësinë e zbulesave.

Nga pikëpamja e ndërtimit libri nuk pretendon ndonjë strukturë të ndërlkuar, përkundrazi niset nga kriteri i krijimit të disa tipologjive konkrete, duke u rrekur sakaq edhe të paraqesë po ashtu disa narrativa nga më të pranishmet në fondin e madh të barsoletave. Vend të veçantë ai i kushton humorit politik para vitit 1990, duke bërë madje edhe polemikë me një studim të një autoreje të huaj se në Shqipëri, në periudhën e diktaturës, humorit politik qe i munguar. Autori paraqet disa nga anekdotat më me “spec” që qarkullonin asohere, të cilat vërtet janë shumë të mprehta, duke theksuar se ky lloj humorit politik pas vitit 1990 erdhi duke u rrudhur dhe duke humbur mprehtësinë dhe fuqinë e fshikullimit. Kategorizime të tjera, të shoqëruara me barsoletat më domethënëse sipas autorit, libri përcakton disa, si: barsoleta që u kushtohen profesioneve të ndryshme, si ato për doktorë, farmacistë, mësues, kamerierë, shitës, berberë; pastaj me interes janë barsoletat me të dehur, me vajzat bionde, me kafshë, barsoletat për marrëdhëniet në çift, ato që lidhen me cilësi, karakteristika e zakone të ndryshme të krahinave të vendit, ku spikat krahina apo qyteti i Gjirokastrës dhe gjirokastritët. Kategori të tjera janë dhe barsoletat kushtuar klerit, sidomos ato me policët etj.

Në përmbyllje të librit të tij Çapaliku sjell në kujtesë disa nga humoristët më të shquar të qytetit të Shkodrës që ishin tejet të njohur për gazmoret e tyre, shumë syresh të bëra popullore dhe që e kaluan perimetrin e atij qyteti. Tefë Palushi (1943-1985), i njohur njëkohësisht edhe si karikaturist, ishte një mendje e mprehtë dhe krijues gazmoresh. Shumë nga barsoletat nuk ishin të tijat, por quheshin si të krijuara prej tij për shkak të emrit që kishte fituar, mprehtësisë së tyre, gjer edhe të mangësive fizike që ai, për fat të keq, kishte dhe e shndërronte vetveten shpesh në objekt humorit. Tano Banushi (1927-1993), aktori i shquar i estradës së Shkodrës, qe edhe një mjeshtër i fjalës dhe frazës humoristike, të cilit i njihen shumë barsoletat. Nexho Shabani (1954), një humorist me veti të lindura e burimore, vijon edhe sot të krijojë në këtë lloj të humorit.



Dy recensa me mendime dhe vlerësime të kundërta nga Kadare dhe Kapllan Resuli për vëllimin "Sot", të poetit Faslli Haliti



Kur disa vjet më parë një djalë i ri nga Lushnja, Faslli Haliti, sillte në redaksi vjershat e para për t'i botuar, ishte e vështirë që të besojë se shpejt do të vinte koha që ai do të botonte librin e tij të parë. Kjo ndodhte sepse vjershat e tij ishin shkruar me mungesa të mëdha teknike, me gjuhë të çrregullt; idetë disa herë nuk ishin të qarta; vjershat disa herë nuk kishin kuptim. Megjithatë, midis strofave të shumta të këtij fillestari shkëlqente tek-tuk ndonjë copë e bukur origjinale poetike e cila, për fat të keq, humbte përsëri në grumbullin e madh të vargjeve të tij. Sikur Faslli Haliti të ishte dashuruar ahëre pas vargjeve të tij, sikur ai të ngulte këmbë dhe të mbronte dobësitë e tij, ishte e sigurt se nuk do të kishim librin e tij *Sot*, që është një nga librat më interesantë poetikë të botuar kohët e fundit nga shtëpia botuese *Naim Frashëri*.

Por ai vinte nga Lushnja, i thjeshtë dhe serioz, si njeri i vërtetë i punës, dëgjonte me vëmendje vërejtjet, mendohej t'i kuptonte ato, nuk "përgjerohej" për ato që kishte shkruar, por i vihej punës të shkruante më mirë, duke flakur dobësitë e shumta. Pas një kohe të shkurtër iu botuan vjershat e para. Koha e botimit të parë është disa herë periudhë e rrezikshme për një fillestar. Pikërisht në këtë kohë mund të krijohet tek ai një vetëbesim i tepruar i cili, për fat të keq, bëhet nganjëherë shkaktari kryesor që disa të rinj e fillojnë mbarë punën, mirëpo pastaj, në vend që të bëjnë përpara, bëjnë prapa. Faslli Haliti, si shumë shokë të tij të talentuar, e kaloi me sukses këtë periudhë. Ai ishte po aq i vëmendshëm ndaj vërejtjeve, po aq serioz në punë si dhe më parë. Ne besojmë se edhe pas botimit të librit të tij të parë, *Sot*, Faslli Haliti, duke e kuptuar thellë se arti është një pasuri që krijohet për popullin, do të vazhdojë të punojë me këmbëngulje dhe përgjegjësi të madhe, ashtu siç ka bërë gjer tani, për të shkruar edhe më mirë, për të zhdukur gjer në fund ato mungesa dhe dobësi që vihen re edhe në librin e bukur *Sot*. Gjëja e parë që të bie në sy në këtë përmbledhje poetike është aftësia e poetit të ri për të komunikuar drejtpërdrejt me lexuesin. F. Haliti nuk mbështillet me "aureolën e krijuesit", duke i folur lexuesit nga lart. Ai, në mënyrë të thjeshtë dhe të natyrshme, e konsideron lexuesin si shokun e vet dhe pa asnjë pozë letrare i flet për problemet që e shqetësojnë:

*Nata,
Bulevardi,
Fshesari dhe unë.
Eja fshesar,
Jemi kolegë.
Ndize një cigar.*

Kjo nuk është një thjeshtësi e shtirur e intelektualit që duket sikur do të thotë: "Shikoni sa poet i thjeshtë jam, bisedoj edhe me një fshesar." Po të lexosh librin e Faslli Halitit, vë re që krye e fund e përshkon një thjeshtësi e vërtetë burrërore:

*Mik me nusen vajta në fshat,
Që nusen time të gjithë të shikonin.
Dolën, plakat, gratë.*

*"Kjo qenka, moj, nusja e nipit të Shahinit?!"
Ç'qenka, moj qyqe, kjo nuse kështu?!"
Kjo të shikoka në kokrrën e syrit,
Supet përjashta, fustanin në gju!"*

Poeti vazhdon të tregojë historinë e vajtjes mysafir në fshat me nusen; me ngjyra të gjalla, të këndshme, duke bërë humor me veten dhe njëkohësisht, duke dhënë një tablo shumë reale të një fshati myzeqar, ku shprehitë e reja po zëvendësojnë çdo ditë etikën e vjetër. Në një vjershë tjetër ai shkruan:

*Futem në klasë,
Nxënësit e mi shikojnë çizmet e mia me baltë,
Flokët e mi të qullur
Që kullojnë,*

DITËT E SOTME NË POEZINË E NJË TË RIU

Ismail Kadare

*Që varen të poshtë,
Si flokët e Senekës.
Shikojnë ditarin e lagur,
Dhe supet qull të xhaketës.*

Në faqet e librit të tij e shikojmë poetin t'i bjerë kryq e tërthor Myzeqesë, të korrë grurë me kooperativistët, të ndezë një cigar me fshesëtarin, të çojë nusen në fshat, të dalë nga një mbledhje e fortë, të shkojë për të dhënë mësim mespërmes shiut, të diskutojë për probleme të ndryshme, të mbrojë me forcë dhe të mohojë me forcë.

Në të gjitha këto vjersha ka diçka të brendshme progresiste. Kjo është një meritë kryesore e poetit të ri. Në vjershat e Faslli Halitit përparimtarja nuk qëndron në fjalë, ajo është brenda vargjeve, brenda subjektit të thjeshtë të vjershave. Duke i lexuar, ti kupton përnjëherësh se këto ngjyra, këto preokupime, këto mendime, këto ngjarje të thjeshta, ndodhin në Myzeqenë tonë, midis njerëzve tanë, në ditët tona. Faslli Haliti mundohet t'i përshkruajë ato në mënyrë të freskët, origjinale, pa shabllone poetike, të cilat krijojnë gjithmonë një perde tymi rreth poezisë. Natyrisht, kjo është një gjë shumë e vështirë dhe jo gjithmonë ai arrin ta realizojë, por disa herë e ka realizuar në mënyrë të shkëlqyer, si të vjersha *Duhej të këndoja i pari, e di*. Po e citoj krejt vjershën:

*E kam hekurudhën te dera e shtëpisë.
Duhej të këndoja i pari, e di.
Nuk këndova,
Isha i mpirë, i hutuar.
Isha si dhëndri në dasmën e tij.
Si dhëndri që pret e përcjell,
Ndërsa të tjerët këndojnë, kërcejnë,
Ndërsa ai në qoshe i lumtur rri.
Duhej të këndoja i pari, e di.*

Për hekurudhën Rrogozhinë-Fier janë shkruar qindra e qindra vjersha nga të rinjtë e të gjitha anëve të Shqipërisë, që morën pjesë në ndërtimin e saj. Ndërsa kjo është fjala e ngrohtë, e sinqertë, e thjeshtë e vendasit, e myzeqarit, për të cilin hekurudha qe dasma e tij.

Faslli Haliti, duke iu shmangur uniformitetit që vihet re në vjershat kushtuar aksioneve, në një mënyrë sa origjinale aq edhe të thjeshtë, shkroi këtë vjershtë të bukur.

Origjinaliteti nuk është vetëm meritë e poezisë, por është kërkesë objektive që poezia të pasqyrojë sa më gjerësisht jetën e popullit. Duke u përpjekur të tërheqim një numër sa më të madh të rinjsh në punën letrare, e bëjmë këtë gjë jo për të nxitur uniformitetin, por pikërisht për ta luftuar. Mbyllja e poezisë në kuadrin e një numri të kufizuar autorësh rrit shabllonet poetike, nxit imitimet, krijon një ndarje midis poezisë e jetës dhe shton uniformitetin. Zgjerimi i radhëve të letrarëve duhet të bëjë të kundërtën. Origjinaliteti nuk është luks. Pasqyrimi në mënyrë sa më origjinale i realitetit tonë në veprat e sa më shumë autorëve, do të krijojë një tablo që mund t'i afrohet pak a shumë tablosë jashtëzakonisht të larmishme

të realitetit tonë. Uniformiteti varfëron dhe zbeh tepër pasqyrimin e jetës sonë. Shabllonet, skemat e gatshme, parafabrikatet letrare nuk sjellin asgjë të mirë. Natyrisht, ka një ndryshim të madh midis origjinalitetit dhe manisë për të qenë origjinal, mani e cila kthehet kundër autorëve dhe dëmton rëndë punën e tyre. Në librin *Sot* bie në sy hapësira, ajri, drita, freskia e motiveve, ngjyrat e çelëta të fushës. Në të gjitha këto ka diçka nga Myzeqeja, nga gëzimi dhe çiltërsia e saj. Për të dhënë imazhet e fushës që e ka lindur dhe që poeti e do me gjithë shpirt, ai përdor një gjuhë të figurshme, me krahasime tepër të kapshme, të guximshme dhe konkrete. Konkretësia është një cilësi tjetër e tij e mirë, që nuk e lë të bjerë rob i spekulimeve të fjalëve. Ja një tablo e së kaluarës:

*Kur në fushë pranvera vinte,
Varte lëkurën gjarpri në ferrë,
Në gjoksin anemik
Pranverat i vinin fushës flutura,
Myzeqarit në gjoks i vinin hoxhallarët nuska.*

Këtu Myzeqeja dhe myzeqari gati-gati janë perceptuar si diçka unike, ku nuk kuptohet ku mbaron fusha dhe ku fillon njeriu. Gjoksi i fushës me fluturat e thara dhe gjoksi i myzeqarit me nuska shtrihen në një krahasim që ka një trishtim madhështor. Krahasimet e ndërtuara me elemente konkrete të jetës janë shumë interesante kur përdoren me vend. Për njeriun që del nga mbledhja e kolektivit ku e kanë kritikuar poeti shkruan:

*Dole kokulur, i skuqur, sigurisht,
Ashtu si sëpata që del nga kovaçi,
Pakëz e skuqur, e nxehur,
Por e kalitur, e mprehur dyfish.*

Ose për kënetat e Myzeqesë ai thotë: "Kish ujë në shpatull Myzeqeja." Disa herë krahasimet bëhen edhe më të guximshme: "Si e çarë e shalqirit, vetëtimja vetë-

tin." Ndoshta konkretësia është tepëruar, por, sidoqoftë, tendenca është e mirë. Në vend që të përdorte krahasimin e stërpërdorur gjatë mijëra vjetëve "vetëtimja si gjarpër", e cila jep vërtet deri diku lëvizjen e vetëtimës, por lë jashtë ngjyrën, poeti nga jeta e përditshme fusharake mori një krahasim edhe më konkret, ku jepet më mirë ngjyra, megjithëse lihet jashtë lëvizja.

Faslli Haliti është një poet që arrin rezultate të mira me përpjekje të mëdha. Kjo është mënyra e të punuarit të tij. Shpeshherë një vjershë e bukur e tij qëndron midis një grumbulli vjershash pa vlerë. Kjo nuk është një gjë shqetësuese, përderisa poeti do të vazhdojë ndaj dobësive të tij, do t'i luftojë këto, të ruajë të mprehur vëmendjen duke u ndarë vazhdimisht prej tyre. Në librin *Sot* gjithashtu ka mjaft dobësi. Disa herë vjershat janë të cunguara, fragmentare, pa ide të rëndësishme; ato duken si skica të paarrira që nuk bëjnë përgjithësim. Duket sikur autori i ka lënë përgjysmë nga shpejtësia ose hutimi. Nganjëherë vjersha nuk del nga kuadri i një konstatimi ose i një krahasimi të thjeshtë. Ka njëfarë "skeletizmi" në vjersha. Poeti i ri duhet që, duke ruajtur cilësitë e tij më të mira të thjeshtësisë, konkretësisë, lakonizmit, të mos i shndërrojë ato kurrë në qëllim në vetvete. Në vjershat e tij F. Haliti ka shpesh impresione të shkurtra, të cilat mbeten thjesht impresione kur nuk shoqërohen me një ide të rëndësishme. Ai duhet të përpiqet t'i shmanget njëfarë "akua-relizmi", i cili duket edhe në vëllimin *Sot*. Duhet të përpiqet, nga ana tjetër, të zgjerojë diapazonin e tematikës së tij. Pa hequr dorë nga freskia e lirikës së fushës, do ta pasuronte poezinë e tij edhe një frymë më e gjerë epike, një nerv më i fortë ndaj ngjarjeve të mëdha me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Të gjitha këto nuk ka pse të kërkojnë përnjëherësh. Këto janë elemente që objektivist e pasurojnë poezinë e një poeti të ri, i cili nuk mbetet në vend, por ecën përpara.

Shkrimtarët tanë të rinj kanë shumë për të mësuar, në radhë të parë nga jeta dhe pastaj nga librat. Ata kanë shumë nevojë për ndihmë. Duhet të ndihmohen nga shkrimtarët më me përvojë. Nga ana tjetër, është e domosdoshme të ndihmohen të rinjtë për të kapërcyer ndjenjën e vetëkënaqësisë pas sukseseve të para. Kur të punohet mirë me të rinjtë, ata do ta kuptojnë shumë mirë se kjo gjë që po bëjmë ne, krijimtaria letrare, nuk është diçka e mbinatyrshme, por është një përpjekje në kuadrin e përgjithshëm të përpjekjeve për përparimin e vendit. Tek të gjithë letrarët, sidomos te fillestarët, duhet të rrënjosen ideja se letërsia nuk është një stolë që zbukuron dhe bën interesante vetveten, por është një pasuri kombëtare dhe, si të gjitha pasuritë shpirtërore të popullit, ajo krijohet me vështirësi dhe mundime të jashtëzakonshme, nga shumë breza e nga shumë njerëz.

Gazeta "Drita", 12 tetor 1969



POEZI QË S’PASQYRON TIPIKEN

nga Kapllan Resuli

Ca kohë më parë shtëpia botuese “Naim Frashëri” nxori në dritë vëllimin *Sot* të letrarit lushnjar Faslli Haliti.

Libri përmbledh 47 vjersha, shumica të botuara në organet e shtypit këto tre-katër vitet e fundit. Bie në sy menjëherë se vjershat e Faslli Halitit janë të shkurtra e kryesisht me varg të lirë; dromca të vogla që lexohen shpejt e po ashtu shpejt edhe harrohen, se kalojnë pa lënë ndonjë mbresë më të thellë. Ka mes tyre edhe krijime më të mira, por shumica janë të sapodala nga djepi diletantesk e pa ndonjë vlerë, ashtu siç e ka konstatuar edhe Ismail Kadareja, që thotë: “Shpeshherë vjershat e tij (të Faslli Halitit) janë të parealizuara. Shpeshherë një vjershë e tij qëndron midis një grumbulli vjershash pa vlerë.” (*Ditët e sotme në poezinë e një të riu*, gazeta “Drita”, nr. 42, datë 12.X.1969.)

Një numër i konsiderueshëm i vjershave të këtij vëllimi jo vetëm që janë të parealizuara dhe pa asnjë vlerë, por paraqesin edhe pikëpamje të gabuara ideo-politike dhe si të tilla, janë denigruese dhe në kundërshtim flagrant me realitetin dhe mësimet e Partisë.

Ndër krijimet më të mira të këtij vëllimi duken *Mbas mbledhjes*, *Panoramë myzeqare*, *Kish ujë në shpatull Myzeqeja*, *Kur vinin pranverat*, *Dhurim gjaku*, *Bisedë me babanë*, *Ai lulëzon* dhe *Duhej të këndoja i pari*, e di.

Kur themi se këto janë krijimet më të mira të Faslli Halitit, kjo s’do të thotë se janë të përsosura e pa të meta. Edhe këto krijime, kush më shumë dhe kush më pak, kush në përmbajtje dhe kush në formë, çalojnë aty-këtu dhe hapin shteg për diskutime, duke i lënë kështu lexuesit shumë për të dëshiruar. Fjala vjen, vjersha *Dhurim gjaku* është e mirë, por katër vargjet e fundit janë të tepërta dhe s’mund të thonë asgjë të re, kështu që kanë mundur redaktorët e vëllimit lirisht t’i heqin vargjet që paraprijnë:

Gjaku im Vietnam,
Është i një grupi me tëndin.

E kanë thënë njëherë atë që pa ndonjë nevojë na e përsërit Faslli Haliti në vargjet: “Shqiptarët gjakun e tyre, një grupi me tëndin e kanë.”

Përsëritje të tilla të panevojshme që e dëmtojnë poezinë ka shumë në krijimet e Faslli Halitit. Në vjershën *Kullimi* ai thotë: “Në ndërjegjen time ka kënetë, pellgje, moçale.” Fjalët “kënetë” dhe “moçale” kanë të njëjtin kuptim. E dyta është edhe fjala e huaj, sllave (moçvara), në kuptimin *ad literum* të fjalës kënetë, kështu që kemi jo vetëm një përsëritje që s’thotë asgjë të re, një përsëritje që e dëmton poezinë, por edhe futjen e panevojshme dhe të padëshiruar të një fjale të huaj.

Te poezia *Duhej të këndoja i pari*, e di, përsëritja e fjalës “ndërsa” në fillim të vargut të parë dhe të tetë jo vetëm që s’ia kanë arritur qëllimit, efektit artistik, por edhe e dëmton shumë ritmin e poezisë dhe rrjedhën e mendimit, duke krijuar kështu një frazë në kundërshtim me sintaksën e shqipes. Për këtë poezi, meqë thamë se është e mirë, duhet të shtojmë se ajo është e mirë vetëm në qoftë se e shikojmë si një autokritikë personale.

Mirëpo, po ta shikojmë në planin e përgjithshëm, ashtu siç duhet shikuar një vepër artistike, ku uni i poetit duhet të shkrihet me unin e përgjithshëm, atëherë na duhet të themi se kjo poezi jo vetëm që s’është e mirë, por edhe shtrembëron realitetin, sepse s’është e vërtetë që rinia e Myzeqesë qëndroi “si dhëndri që pret dhe përcjell”, ndërsa të tjerët po ia shtronin “hekurudhën te dera e shtëpisë”. Rinia e Myzeqesë hodhi kazmat e para dhe të fundit krah për krah me rininë e krahinave të tjera që vërshoi në Myzeqe. Rinia e Myzeqesë i priti dhe i përcolli vëllezërit e motrat e krahinave të tjera jo “e mpirë” dhe “e hutuar”, siç thotë F. Haliti, por me këngë dhe valle, duke kënduar e duke kërcyer.

Ndaj edhe themi se për këtë poezi Faslli Haliti është për t’u përgëzuar për rrëfimin dhe autokritikën e sinqertë të ngritur në art, por ama ai duhet të dijë se çështja personale që nuk shkrihen në çështjet e përgjithshme lexuesit pak ose aspak i intereson. Kur këto çështjet lënë shteg edhe për interpretime të padëshiruara, atëherë është më mirë që të mos ngrihen fare, në qoftë se s’kemi aftësitë dhe forcat për të ngritur në art ashtu siç duhet, duke i shikuar përmes kuadrit të përgjithshëm, përmes asaj që është tipike.

Ndër krijimet që porsa kanë dalë nga djepi diletantesk mund të përmendim *Kullimi*, *Veç kujdes*, *Kthimi i Skënderbeut*, *Rruga*, *Kolegu*, *Rini*, *Lulëzimi dhe ne* dhe *Zhurme*.

Mendimi ynë si lexues është që vëllimi duhet të kishte dalë vetëm me këto vjersha. Sa u përket 31 vjershave të tjera, ne rezervojmë mendimin tonë. Peizazhet *Pranverë*, *Shi maji*, *Ardhja e vjeshtës*, *Unë nuhas pranverën*, *Marsi në Sarandë* dhe *Shije të reja* neve na duken tepër të përgjithshme, pa jetë, pa ngjyrë kombëtare.

Marsi,
Me kokën e kaltër,
Me trupin e gjelbër,
Kitarën e ujërave vari në qafë,
Si tela kitare rrëketë i dredh
Luleve, blerimit, iu bën serenadë.
Marsi në Sarandë

Mbi koka jeshile pemësh
Natyra derdhi bojë të verdhë
Vjeshta krahët e artë
Mbi fusha i hodhi
Dhe kodrave lart.

Ardhja e vjeshtës

Nyja, nyjën thërret.
Me rrezet paralele zgjaten kërcejtë,
Blerimi hap syrin e gjelbër gjithë qejf,
Ujërat pranverore buzëqeshin të qeta,
Pemishteve pjeshka fustanin e purpur
Nis zbukuron me lulet e veta.

Unë nuhas pranverën

Ja disa strofa të këtyre peizazheve ku mania dhe dora e njeriut tonë nuk duket asgjekund. Këto peizazhe bien erë kozmopolitizëm, sepse kjo natyrë që na vizaton autori nuk pasqyron transformimin socialist në fshatin tonë fushor apo malor, nuk ka asgjë kombëtare, asgjë shqiptare. Vargje të tilla për natyrën kanë shkruar dikur romantikët dhe sot shkruajnë poetët e rrymave të ndryshme, por kurrsesi shkrimtarët e realizmit socialist, për të cilët kozmopolitizmi, si armë e nacionalizmit borgjez, është i huaj.

Panorama e Myzeqesë që na jep Faslli Haliti nuk është ajo e ditëve tona. Ai thotë:

M’i madhi mik i fushës, plugu,
Mbi skenën e blertë këndon
Një kor drapërinjsh, kazmash, kombajnash
E shoqëron.

Është e vërtetë se dikur ka qenë “M’i madhi mik i fushës, plugu”, mirëpo sot kjo panoramë ka ndryshuar. Në vend të plugut kemi traktorët që buçasin anembanë Myzeqesë dhe në vend të krahëve të njëri-tjetrit kemi kombajnat dhe makineritë e tjera agroteknike. Bujqësia jonë është modernizuar dhe plugu s’është më “miku më i madh i fushës”.

Dhe, ajo që është më e rëndësishme, në Myzeqe sot vjeshta nuk sheh më fytyrën e vet “mbi pellgje me ujë” (*Ardhja*

e vjeshtës). Këtë pasqyrim e ka pasur vjeshta në Myzeqenë e bejlerëve dhe agallarëve, por jo në Myzeqenë e Partisë dhe të popullit punues.

Me plot të drejtë na thotë një agronom në Lushnjë: “Në qoftë se është e vërtetë ajo që thotë Faslli Haliti në vëllimin e tij *Sot* për Myzeqenë, në qoftë se është e vërtetë se vjeshta sheh fytyrën e vetë mbi pellgjet me ujë këtu në Myzeqe, atëherë Partia dhe Qeveria duhet të më hedhin hekurat në duar, se më kanë vënë në dispozicion miliarda për t’ia ndryshuar pamjen Myzeqesë, për të tharë kënetat dhe pellgjet, që vjeshtat më të mos shohin fytyrën e tyre mbi pellgjet me ujë. E këtë gjë duhet ta dijë fare mirë Faslli Haliti, se edhe në qoftë se s’ka kaluar në fushë për të parë ndryshimet kolosale, sihariqi i këtyre ndryshimeve duhet t’i ketë arritur edhe në dhomën e tij prej fildishi, ku me siguri nuk dëgjohet piskama e mushkonjave.”

Ja dhe disa vargje nga vjersha *Shije të reja*:

Retë lëshojnë shiun mbi tokë,
Zbardhon si vijë e bardhë horizonti,
Zverdhin zhabinat e verdha,
Më kërkuat fusha?
Ara, fshatra –
Erdha.

Vallë, tri vargjet e fundit të kësaj strofe a nuk edukojnë te lexuesi pasivitetin dhe nënshtrimin e njeriut prej natyrës? Si është e mundur që fshatari ynë kooperativist i edukuar nga Partia me botëkuptimin materialist, sot, mbas 25 vjetësh, përsëri të presë lëmoshë nga natyra? Kësaj i thonë të shkruash larg fshatit dhe fshatarit, që nga tavolina. Do të ishte mirë që më parë autori të vizitonte rezervuarët e Thanës, hauzet dhe kanalet vaditëse anekënd Republikës... Por e keqja sqëndron këtu.

Le të ndalemi te vjershat *Sot*, *Kuadrove që nuk u iket*, *Në fushë*, *Unë mësuesi i fshatit*, *Mik në fshat*, *Ike*, *Ajo*, *Kaloj*, *Nata* etj.

Njerëz që venë në kamp në Durrës,
Që venë të takojnë të fejuarën,
Që nisen të shohin një ndeshje futbollit,
Që nisen të marrin provimin e parë,
Që nisen të marrin provimin e fundit,
Që nisen kufirit ushtarë.

Po të heqim vargun e fundit, autori në vjershën *Sot* na server si problemet më shqetësuese të kohës sonë pushimin, dashurinë dhe diplomën për të garantuar qetësinë personale. Ç’vargje të neveritshme!

Vallë, s’kishte mundësi autori në vjershën *Sot* të na paraqiste iniciativa që kanë lindur në gjirin e të rinjve dhe të masave për të zbukuruar malet me tarraca, për të përvetësuar mësimet e Partisë dhe të shokut Enver, për të hequr dorë nga prona personale, për të mësuar gjithë artin ushtarak etj.?

Sot! Vallë, ku duket heroizmi masiv, ku duket solidariteti popullor, ku spikat uniteti moralo-politik Parti-Popull?! Askund, askund, veç predikimeve të sëmura... veç predikimeve alla-revizioniste... veç rrugëve pa krye:

Njerëz që ikin kudo,
Ku të mundin...
Sot

Besnikëria dhe gatishmëria e kuadrove tona të edukuara nga mësimet e mëdha të Partisë për të vërshuar poshtë, ku e lyp nevoja e atdheut – ja lajtmotivi që duhet të frymëzonte Faslli Halitin. Por këtë fakt autori e ka injoruar në vëllimin e tij, duke shkruar:

Kuadro kudo nëpër poste ku jeni,
Që dot nuk ju iket
Që dot nuk ju zbritet.
Kuadrove që nuk u iket

Vallë, ky është realiteti ynë? Kurrsesi! Faslli Haliti do të bëjë mirë që të njihet me të gjitha kuadrot e reja që kanë zbritur nga kryeqyteti në qytetin e Lushnjës dhe ndër të gjithë qytetet dhe fshatrat e Shqipërisë, për të kuptuar se tipari karakteristik i kuadrove tona nuk është “ngurrimi i imagjinuar nga Faslli Haliti, por besnikëria dhe gatishmëria

e tyre”. Nëse autorin e zë meraku për ata pak individë trumykur e burokratë që nuk shohin më tej nga hunda e tyre, e këshillojmë që të mos shqetësohet, sepse revolucionit fitimtar nuk i bëhet vonë për të tillë bashkudhëtarë miopë dhe egoistë.

Kemi përpara vjershën *Në fushë*. Lexojmë:

*Nuk prashitet më,
Nuk korret më,
Vapë
Sa s’ka.*

Stepjen nga vështirësitë, ja ç’na edukojnë këto katër vargje! Sjellim ndër mend vargjet e poetit tonë të respektuar, F. S. Noli:

*T’u tha gryka po s’të pihet,
T’u mpi këmba po s’të rrihet,
Se mileti po të pret...
.....
Shpejt or Marathonomak!*

Ç’optimizëm na ngjallin këto vargje të shkruara 39 vjet më parë!

Sa keq na vjen që Faslli Haliti, në vend që të na japë figurën e Marathonomakut të ri të kalitur në kudhrën e Partisë, na servir një fshatar, individ i cili, pasi u than gjoksin katruveve, ngul kazmën në tokë dhe ia fut gjumit nën hijen e gorricës. E ç’mund të mësojë lexuesi prej një vjershe të këtillë, ku as nuk duket puna kolektive, ku askund nuk vështrohet teknika dhe agroteknika, ku veç misrit dhe grurit nuk mbillet asnjë kulturë tjetër, ku autori predikon përtacinë dhe stepjen nga vështirësitë? Dhe kur? 39 vjet mbas Marathonomakut të F. S. Nolit, kur ne me plot të drejtë presim prej poetëve tanë që, së paku nga ana ideore, të qëndrojnë më lart se F. S. Noli.

Lidhur me vjershën *Mik në fshat*, që është një ndër vjershat më të mira të këtij vëllimi dhe që ka vargje dhe pasazhe të mrekullueshme, është shkruar në ndonjë artikull kritik se gjoja këtu na u pasqyruakan ndryshimet social-ekonomike që po ndodhin në fshatin tonë socialist etj. S’ka si të mos qeshim me këtë vlerësim subjektivist, që bie në kontradiktë me vargjet e letrarit të ri i cili, në mes të tjerash, thotë:

*Daja fshatarëve nuk la pa u thënë:
Nusen me nipin sonte kam miq,
Po dreqi ta hajë se sot bukë gruri
Plaka ime s’paska gatuar!
Po jemi në kohën e lëmit, moj plakë!*

A nuk flasin këto vargje për një fshat më të prapambetur dhe të pakolektivizuar, ku secili fshatar ka magjen dhe lëmin e tij?

Nëse Shahini do të paraqitej si anëtar i kooperativës, ankesa e tij do të ishte absurde, sepse në kooperativë anëtarët bukë nuk gatuajnë vetë, por e marrin në dyqanin e bukës, ndërsa lëmenjtë janë pronë e paprekshme e kolektivit të bashkuar. Autori gjithashtu ka harruar faktin se shallvaret dhe tumanet nëpër fshatra tona fushore dhe malore janë zëvendësuar me veshjen e lehtë socialiste.

Kjo qenka, moj, nusja e nipit të Shahinit?!
Ç’qenka, moj qyqe, kjo nuse kështu?!
Kjo të shikoka në kokërr të syrit,
Supet përjashta fustanin nën gju!

Ky fanatizëm, ky ambient fshataresk, bie në kontradiktë me fshatin e ri socialist ku të rejat dhe nusët po shkallmojnë dita-ditës zakonet e vjetra, po luftojnë thashethemet, po përqafojnë normat e moralit të ri, po futen gjithnjë e më shumë në rrugën e përparimit, po marrin pjesë gjallërisht në të gjitha fushat e jetës.

Asnjë përgëzim nuk meriton edhe vjersha *Unë, mësuesi i fshatit*, sepse autori, në vend të figurës së mësuesit, komisar drite dhe përçues i politikës së Partisë në fshat, na ka dhënë figurën e një mësuesi qesharak:

*Pantallonat e mia zhytur në çizme,
Flokët e mi të qullur
Që kullojnë,
Që varen teposhtë,
Si flokët e Senekës.*

Ky mësues është katandisur në këtë gjendje, sepse “imazhi i vajzës bukuroshe” e tërheq vazhdimisht drejt qytetit. Në asnjë varg ky mësues nuk del si aktivist shoqëror në fshat. Mendja e tij është e mbarsur vetëm me formula, konveksione dhe “eksklamacione”. Ky lloj mësuesi s’ka asgjë të përbashkët me Ndrec Ndue Gjokën, Ismet Sali Bruçajn, me mësuesit e Kolonjës e të Mirditës dhe me mijëra e mijëra mësues të tjerë që lumturinë e gjejnë në fshat, në gjirin e fshatarësisë kooperativiste.

Në një kohë kur Partia lufton për emancipimin e femrës shqiptare, në një kohë kur udhëheqësi ynë i madh, shoku Enver Hoxha, ngre lart gjestin e qytetares Athina Mile që zgjodhi për bashkëshort një të ri kooperativist nga Malësia e Mirditës, Faslli Haliti në poezitë *Ajo* dhe *Ike* na e paraqet femrën të varfër shpirtërisht dhe të prapambetur nga ana ideore:

*Jam qytetare,
Jeni fshatar,
S’mund të martohemi bashkë!*
Ajo

*Në livadhin e blertë të shpirtit të ri
Me lule ndjenjash, dashuri të njomë,
Ishe.
Por ike,
Ike skëterrës së shpirtit të tij,
Ku lulëzonte vetëm një diplomë.*
Ike

Ashtu si te vjersha *Kuadrove që nuk u iket*, edhe në këto dy vjersha të vogla autori nuk ka kapur tipiken që ne e shohim të mishëruar në gjestin e Athina Miles dhe të qindra arsimtareve myzeqare dhe korçare, që vullnetarisht kanë shkuar në zonat e thella malore të Veriut për të shërbyer si edukatore të brezit të ri.

I padrejtë na duket krahasimi i natës me nënën e dëshmorit që i dha Luftës Nacionalçlirimtare djaln apo vajzën e vet: “Nata, si nënë dëshmori me sharpin e zi...” Dhe jo vetëm në këtë vjershë. Krahasimet e Faslli Halitit thuajse nga vjershë në vjershë çalojnë. Paralelizmi i pranverës me hoxhallarët dhe i fluturave me nuska në poezinë *Kur vinin pranverat* tregojnë papjekuri të theksuar.

Shenja formalizmi dhe manierizmi vëmë re te vjersha *Kaloj*, ku e gjithë amfora na duket e kërkuar artificialisht, në kundërshtim edhe me natyrën e gjuhës sonë, e cila pranon të tilla frazeologji: “buzë lumit”, “buzë liqenit”, “buzë detit”, “buzë malit”, por kurrsesi; “buzë vetullave”, “buzë syve”, “buzë flokëve”, “buzë buzëve” etj.

S’jemi dakord as me konceptin ideo-politik të autorit që, duke kaluar tek traseja, nuk sheh tek aksionet tona dashurinë ndaj Atdheut, por dashurinë seksuale; nuk sheh bukuritë e sakrificës dhe të vetëmohimit, bukuri të entuziazmit rinor, të patriotizmit dhe të ndërgjegjes së lartë socialiste, por bukuritë e syrit të aksionisteve, të buzëve vishnje, të syrit, të vetullave, të trupit të hijshëm



Kapllan Resuli

dhe flokëve. Autori shpif me paturpësinë më të madhe kundër aksionisteve tona, kundër motrave dhe bijave tona, duke thënë se një njeriu të tillë, ato me qindra ia bëjnë me dorë, e ftojnë për dashuri seksuale. Kjo, siç thamë, është një shpifje e paturpshme dhe e palejueshme se njerëzve të tillë aksionistet tona, rinia jonë, jo vetëm që s’ua ka bërë dhe s’ua bën me dorë, por u ka pështyrë dhe u pështyn në surrat dhe ka marrë e merr masa kudo që i zbulon për edukimin e tyre. Një mendim i tillë i autorit assesi s’pajtohet me realitetin ndër aksionet tona, ku shkohet për t’u kalitur ideologjikisht e fizikisht dhe jo për t’u dashuruar.

Partisë Faslli Haliti i kushton vetëm vjershën *Kudo*, e cila s’është gjë tjetër veçse pllakat, ku PPSH-në e gjejmë vetëm të shkruar: “mbi mezhda”, “bri rrugës”, “në ballin e malit”, “mbi faqen e xhamit”, “në hyrjen e një fabrike”, “në prolog të një poeme”, por jo në zemrat e njerëzve të cilët nën emrin e saj munden me furtunën, me zjarrin, me tërmetin, me armiqhtë e revolucionit dhe kurdoherë dalin fitimtarë.

Në vëllimin *Sot* ndeshemi edhe me krijime shumë të dobëta nga ana artistike si, fjala vjen, *Lushnja natën*, që s’paraqet asgjë të re, asgjë të veçantë për Lushnjën si qytet i rëndësishëm bujqësor dhe industrial.

Fakti që autori s’na flet as për punëtorët e turnit të natës, as për bisedat e nxënësve që kthehen nga shkolla e bashkuar pa shkëputje nga puna, as për traktorët që në periferi të qytetit zhurmojnë gjer në orët më të vona të natës, na bën të mendojmë se Faslli Haliti e sodit jetën vetëm nga larg.

Vjersha *Kujtimi im nga një ekskursion* inkuadrohet ndër krijimet më të dobëta, të pafrymëzuara, ku vetëm përmenden objekte ku autori dhe kolegët e tij kanë parë dhe kanë marrë me vete. Në përgjithësi, poezia e Faslli Halitit është një poezi e përciptë, pa frymëzim, e ftohtë, e për më tepër denigruese, sepse ai nuk e vështtron realitetin tonë ashtu siç është, por siç ka qenë dikur, nuk krijon poezi të realizmit socialist, por poezi të sëmura që dalin duke e vështruar realitetin përmes një prizmi personal e të huaj për ideologjinë tonë.

Çuditëmi me autorin e shkrimit kritik *Ditët e sotme në poezinë e një të riu*, botuar në gazetën “Drita”, që është shprehur se vëllimi *Sot* na qenka një nga librat “më interesantë poetikë të botuar kohët e fundit” nga shtëpia botuese “Naim Frashëri”. Ose: “Në vjershat e Faslli Halitit socializmi nuk qëndron në fjalë, ai është brenda vargjeve, brenda subjektit të thjeshtë të vjershave”. Për ç’socializëm e ka fjalën autori i artikullit? Partishmëria jonë te vëllimi i Faslli Halitit është e jashtme, qëndron vetëm në fjalë dhe nuk futet në brendi të subjektit. Për sa u përket vjershave të gabuara, ajo është edhe e huaj.

Ne dhe shumë pjesëmarrës të diskutimit krijues të organizuar nga Shtëpia e Kulturës e qytetit tonë për librin *Sot* s’pajtohemi as me mendimet subjektive të Ismail Kadaresë dhe as me çmimin e tretë që juria e poezisë i dha këtij vëllimi në konkursin e madh kombëtar të shpallur me rastin e 25-vjetorit të çlirimit të Atdheut tonë. Jemi të mendimit që autorëve të rinj u duhet dhënë ndihmë për të përvetësuar mësimet e Partisë, për të njohur jetën dhe për të zotëruar artin e të shkruarit, por në asnjë mënyrë të mos u bëhen lëshime në ideologji ose t’u fërkohen krahët kur ata nuk e meritojnë. Tek autorët e rinj nuk duhen vlerësuar vetëm manitë e tyre për të krijuar figura bajate:

*Kamerierja puhi
servir freski.*

Apo:

*Kooperativa berbere e rreptë
flokët e ferrave fare i qethi.*

E themi këtë, sepse figura të tilla, tendenca formaliste dhe manierizmi, e bëjnë lexuesin tonë të revoltohet, të pështyjnë në atë poezi dhe të thotë: “Kjo nuk është poezia që unë kërkoj nga poetët e realizmit socialist.”

Kapllan Resuli, shkrimtar
Spiro Dinaku, nëpunës
Hysen Kurti, punëtor

Arkivi Qendror i Shtetit. Po aty. Fondi 14. Ap. Komitetit Qendror të PPSH-së, (Struktura) Dosja 308. Viti 1973

EXCELSIOR

poezi nga

Jolanda Kodra

SHPIRTI

Ka një kopsht të mistershëm
Që për të pamaturin vështtrim
Rrugën e ka të mbyllur.
Ka një kopsht të mistershëm
Që ia ruan të fshehtën
Porta e jashtme e hyrjes.

Po, ashtu si na thotë përralla
Që me fjalën “Sezam” u çel
Shpella e magjepsur e thesaret
Dritëplotë zbuloi, mendojmë
Se me një fjalë magjike
Dyert e mbyllura do të hapë
Lulet e veta dhe do të shfaqet
Së fundi kopshti enigmë.

Zemrës po t’ia lypim fjalën
Që të hapë gardhin magjik
Do të pëshpërisë ajo: “Dashuria
shpesh e ka këtë fuqi”.
Fjalë e ëmbël kjo
Që shpesh e ka zgjidhur enigmën.

Veç jo gjithmonë. Ka raste
Që hyrja e ruan të fshehtën
(kështu i fshihet vjollca vështtrimit)
Gati me një të pamposhtur
Mur rrethues ai na shfaqet.

Ka një kopsht të mistershëm
Që quhet “shpirt njerëzor”.
Gjithkush e ka në vetvete.

Ka një kopsht të mistershëm
Që shpesh edhe ai që na do
S’arrin dot t’ia çelë dyert.



JOLANDA KODRA (1910-1963)

Kritike, përkthyes, poete, me origjinë italiane, ka qenë një nga autoret e njohura të viteve 30-40-të. Pas lufte iu kushtua kryesisht përkthimit. Shkroi edhe një komedi me një akt, të pabotuar, “Tabloja”.
Në fund të jetës (gusht 1963) shkroi dy lirika që qenë si “Kënga e mjellmës” së saj, “Excelsior” dhe “Melankoli”. Si poete lëvroi lirikën meditative me një ngjyrim romantik. Temat e saj të parapëlqyera qenë natyra dhe enigmat e jetës.

Endet në ajrin e vjeshtës
floriri i gjetheve të dridhshme
që era larg i shpërndan,
si ëndrra të paarritshme,
megjithatë ndonjëra
ulet pranë nesh
me një t’ëmbël
pëshpërimë
si një i vogël gëzim
që vjeshta na dërgon
që të na japë ngushëllim
për verën që iku, fluturuese.

S’je më, s’je më në zemër tani,
Ëndërr e largët që në rini m’u ndez,
Po mendimi im ende me dhëmshuri
Po të thërret, kujtim që kurrë s’vdes.

Dhe në të kaltrën e shpëlarë të gjërave
Dikur të shtrenjta që nuk janë më,
Ti vjen, e ëmbël dhe ende s’më lë,
Më ngushëllon në orët më të errta**

FATAMORGANA[†]

Ku je, ku je ti vallë, fatamorganë,
Ti nga artistë e poetë e ëndërruar,
Vegim ajror bukurie të paanë,
Që i bën të lumtur shpirtrat e munduar?

Nga shkëlqimi i diellit e rrethuar
Apo nga mjegulla dhe melankoli,
Ti je mbretëria e Muzës së amshuar,
Atdheu i atij që do t’ëmbëlën poezi.

Na tregon tisin e bruztë që mbështjell
Auxhelikën* e bukur tek po rend
Mes pyjesh të errta dhe të qartit qiell
Majë kalit, drejt fatit që e pret.

Ti e bën xhindin e ajrit, Arielin[§]
Të shkëlqejë me të pastrën bukuri,
Ti bën çdo gjë, të vërtetë a legjendë
Të marrë jetë e t’perhershme rini.

Ti ia shton gëzimin atij që është
i lumtur dhe atij që vjen tek ti i pangushëllim
vegimi yt i thotë aq shumë
sa shpirti i tij larg ngrihet fluturim.

Dhe unë në të largtat vite që s’janë
Ndiqja ëndërrën e ëmbël që je ti
Të shihja e të doja ty, fatamorganë.
Tash të kërkoj e s’të gjej kurrsesi.

ANKTH

Në të natës heshtjen aq të thellë
Shpirti ndjen një shtrëngim që e ndan
në mes.

Bien iluzionet që dita të sjell,
Dynden mendimet si kuaj të zes.

E ardhmja ngjan e pasigurt dhe e zbetë.
E tashmja porsi gur në gjoks rëndon,

* Këto tri vjersha botohen për here të parë.
[†] Mirazh në shkretëtirë. Është bërë sinonim i iluzioneve.
[§] Personazh i “Rolandit të tërbuar” të Ariostos.
[§] Personazh i “Shtërngatës” së Shekspir.

“sot” e “nesër” të vështrosh s’guxon
Që dhimbja mos të bëhet më e mprehtë.

E atëherë strehë gjen në një të
kaluar,
Në kohën e ikur që s’e kthen asgjë
Dhe që larg ngjan më e gëzuar.

Të ngushëllon atëherë ai vegim
Gjërash të bukura që s’të qeshin
më,
Fantazmash që thërret plot përgjërim.

EXCELSIOR

Në të errtën kupë të jetës
Ndrin fshehtësia mijëvjeçare e yjeve
Ashtu si ka ndritur përherë
Nga thellësia e kohërave.

Po tash që njerëzit njohën
Të papërfytyrueshmen heshtje të kozmosit
Dhe panë poshtë të vërtitet
Planetin tonë të shtrenjtë.

Vështtrimin sërish ngulin lart,
Ëndërrojnë përralla të reja
të mrekullueshme
Dhe shohin tek yjet
Atdheun e ri të njerëzimit
tëardhshëm.

Dhe koha atëherë s’do të jetë
më tirane
dhe njerëzit mbase do të mund
të realizojnë
të lashtën ëndërr të rinisë
së përjetshme.

1963

MELANKOLI

Aromë gjërash të largëta,
Të tretura në kohë
E që mandej,
Nga koha zbutur, zbukuruar,
Si hije fluide i rikthehen
Kujtesës.

Vajtim për çka nuk qe,
Për çka për ne s’do t’jetë më,
Për çka shkëlqen më kot,
Përtej rrethit që i ve cak
horizontit tonë.

Hi akoma i nxehtë
Dëshirash që u dogjën
Në zemrën tonë rinore
Dhe, pa lëshuar dritë flake,
Dalëngadalë u shuan,
Të panjohura, të pakuptuara.

Hije të vagëlluarash, jetëshkurtërash
Shpresa që më s’i besojmë,
Po që zemra jonë u ngjitet,
Të rrojë, të mos vuajë.

Ëmbëlsi si qeni i trishtuar
Dhe në shpirt ta ndjesh
Një frikë të pakuptuar
Nga njëmendësia e padashuruar.

Muzg i ngadalshëm drite
Që tretet me butësi
Duke lënë në hijen që zbret
Një të ndritshëm refleks.

1963

KUR VETMIA VETON

poezi nga
Afrim Demiri

1. KUR VETMIA VETON

Kur vetmia veton
në zemrat e vrame
lirikat pikojnë
si qershitë

Nga shekët e krisura
rrjedhin kujtimet
e trishta

Një magjistare në jermi
i lidhë udhët nyje
dhe mallkon yje

Në gjembat e trëndafilave
të pa çelur
shkyhet këmisha e pranverës
së humbur

Lulet në herbarium
ruajnë polenin
e ringjalljes

2. PËRPIRËSI

Jam vetëm
një përpirës
i mllëfit vetmitar
i pështymës
që nuk e nxjerri
jashtë

Përpijë tështimen
time si nje vullkan
që s'guxon
të shpërthejë

Fjalët i kafshojë si
kupa e kallamoçit
të mos i lëshojnë
stërkalat mallkuese

O vetveten përpijë
si një virus
që duhet të mbytet
të mos vijë
tek ju

Koha koha si lëmsh
leshi nuk po përpihet
Dot
derisa e nesërmja
të më liron nga
Përpirja

3. TORZO E ÇMENDUR

As nuk më prek kush
as që preku kënd

Mungesa e prekjës
ma ka tha lëkuren
si gëzhojë të veve
të prishura

Trajtat kanë humbur
përmasat si në mjegull

Me duart e stërkequra
me gishtat si krande të thata
me krahët e ngjitur për shtati
nuk jam ma unë
Kam mbet
një Torzo e çmendur
si dordolec pranvere

Nga shikimet e trishta
frika më shiton
si prekje meduze
nuk e njoh as kurmën
time

Edhe le të më pickon
dikush
vetem le të me prekë
ta dije që jam gjallë
nga kjo dergjë e keqe

4. SHIKIM NGA KATI I SHTATË

Kulmeve vetmia
ka dalë për gjah
si mace e pangjyrë
hija e reve të zemruara
mbulon trumcakun
e dremitur në qeremide
Ulluqet mbledhin
pikëllimin e ditëve
të izolimit

Xhita e humbur
në qiellin e mërzitur
vizaton zik-zaket
e frikës në renë
me portret fëmije

Oxhaqet nuk tymojnë
pëllumbat e teneqes
nuk tregojnë kah fryejnë
erërat e pritjes

Shikim nga kati i shtatë
Teleskopi i vërbuar
e huq Siriusin

Poshtë atje poshtë
udhët si litarë cirku
presin udhëtarët
që s'vijnë
Automobilët janë kthyer
në breshka të ngordhura

Malli për hijet e njerëzve
kacavjerret nëpër rrufepritës
dhe përplasat për tokë

Nga kati i shtatë
nuk shihen gjurmët
e coronavirusit

5. VETMIA VIRUSALE

Brenda
vetmisë virusale
herë jam një orendi
herë perde plastike
në dritare mbylli dritën
e rrejshme

Sa për librin e fundit
s'jam tjetër përpos
një lexues prej dylli

I mbështetur për frigoriferi
si skulpturë e refugjatit
të uritur jam
e pasderës së dhomës
shportë e stërmbushur
e mbeturinave

Në qoshen artistike
aty ku rri ora e zallit
jam vazo për lulen
pikëlluese të orchides

Prej ditës në ditë
si rruzare të njëjta
jam peri që pret
të këputet

E rruzat kobndjellëse
të shkojnë në theqafje

6. SYTH I PRANVERËS VIRUSALE


Fytyrën ma mbulojnë
myshqet dhe likenet
si një guri të humbur
kohe

M'i fshehin
grimasat e vetmisë
me maskën green
kundër coronavirusit

Vrushkull rrezesh
tejpërtej hijes time
rrezojnë shpresat
e humbura honeve

Jam një syth
i pranverës virusale
në trungun e lisit
të vrarë rrufeje

Lumi rrjedh
brenda meje
si drejt detit
pa pyetur
për kohën
për virusin



(Libri "Lëvizja Protestante te shqiptarët: 1816–1908" i autorit David Hosaflook)

Shqipja e shkruar – “terra incognita” në fillimshekullin XIX

Nga Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)




Në librin e albanologut dr. David Hosaflook, *Lëvizja Protestante te shqiptarët: 1816–1908*, trajtohen çështje të shumta e me larushi, duke filluar nga konteksti teologjik, historik dhe shoqëror i Lëvizjes Protestante te shqiptarët, Dhiata e Re për herë të parë në gjuhën shqipe, veprimtaria ungjillore përkrah veprimtarisë arsimore, arsimimi i femrës shqiptare, përpjekjet e njëkohshme të Lëvizjes Protestante dhe Rilindjes Kombëtare Shqiptare e deri te botimet e ndryshme në gjuhën shqipe dhe përhapja e tyre anembanë trevave shqipfolëse, për të cilat, D. Hosaflook ndalet gjatë në studimin e tij. Por, ajo çka më impresionoi më së pari, si redaktore e këtij botimi, ishte sidomos interesimi i Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (*BFBS, British and Foreign Bible Society*), për lëvrimin e gjuhës shqipe, si dhe gjeneza e shpërndarjes masive të botimeve shqipe, përmes strategjisë së librashitësve shëtitës. Duke qenë se shqipja në fillimshekullin XIX ishte një gjuhë e palëvruar, ata erdhën jo vetëm me shkrimet e shenja në shqip, por edhe në të dyja dialektet, fillimisht në toskërisht e më pas në gegërisht. Edhe pse pikësynimi fillestar dhe ai përfundimtar i Shoqërisë Biblike ishte pa dyshim *ungjillëzimi* – përmes përkthimit të shkrimeve në gjuhën amë (si përmbushje e parimit *Sola Scriptura*) dhe shpërndarja masive të tyre, ata ndikuan edhe në lëvrimin e shqipes së shkruar. Misionarët protestantë erdhën në trojet shqiptare kur ende nuk ishte shfaqur ndonjë lëvizje arsimore apo të kishte ndonjë rrjet shkollash në gjuhën shqipe. Kështu, sot na duhet t'i shprehim mirënjohjet më të thella misionarit protestant Robert Pinkerton – i cili qe i pari që i bëri shqiptarët objekt të BFBS-së – dhe gjuhëtarit Jernej Kopitar – i cili hodhi idenë e përkthimit të Biblës edhe në gjuhën shqipe.

Libri *Lëvizja Protestante te shqiptarët: 1816–1908* dritëson disa prej të dhënave kryesore mbi botimet në gjuhën shqipe dhe përpjekjet e misionarëve të huaj: William Jowett, H. G. O Dwight, William Schaufler,


Jonas King, Rufus Anderson etj., dhe më pas atyre shqiptarë: Gjerasim, Qiriazi, Gjon Ciko, Gjergj Qiriazi etj., për kombin tonë dhe ndriçimin e tij shpirtëror e arsimor njëherazi. Populli shqiptar do të ishte gjithnjë e në interes për të shpërndarë Shkrimet e Shenjta, të cilat do të ndiqeshin prej proceseve që do të ndihmonin arsimin në gjuhën amë, madje Nathalie Clayer në librin e saj *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, shprehet se: “...përpara se të vinin protestantët, asnjë grup tjetër nuk kishte bërë përpjekje kaq serioze për botimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe”. Misionarët protestantë kishin pikëpamje tepër të përparuara për kohën, madje shpesh u ndeshën edhe me kundërshtime të autoriteteve fetare ose atyre shtetërore, të vendeve ku ushtronin veprimtarinë e tyre. Përveç shpërndarjes së Shkrimeve të Shenjta në gjuhën amtare, ata në mënyrë të tërthortë ndikuan edhe në çështjet kombëtare, përmes shpërndarjes së abetareve dhe gramatikave, arsimimit të të dyja gjinive, si dhe barazisë arsimore dhe shpirtërore te njerëzit e thjeshtë. Sipas D. Hosaflook “shoqëritë misionare protestante hynë në territoret shqiptare me qëllim për të botuar dhe për të shpërndarë Shkrimet e Shenjta në shqip, për të nisur shërbimet ungjillore në gjuhën shqipe, si edhe për të hapur shkollat në gjuhën shqipe. Me këto veprimtari, ata konsideroheshin se po ndihmonin shqiptarët për t'u shqiptarizuar”. Përparimi social, zhvillimi i arsimit në gjuhën amtare dhe ndriçimi letrar ishte pjesë e qenësishme dhe e pandërprerë e besimit fetar që ata përfaqësonin. Prof. Ferit Duka, në parafjalën e librit, shprehet se: “Protestantizmi për shqiptarët nuk ka qenë thjesht besim, por edhe një nxitës i fuqishëm i zgjimit kulturor dhe i përpjekjeve për arsim në gjuhën amtare, një urë e fortë komunikimi e shqiptarëve me qytetërimin perëndimor. Misionarët e këtij besimi në Shqipëri kudo që shkuan, mbollën jo vetëm dashurinë për Zotin, por edhe dashurinë për gjuhën shqipe dhe respektin për vlerat e kombit shqiptar”.

Deri më sot është folur gjerësisht për fillesat e shqipes së shkruar po dhe për botimet e para në gjuhën shqipe, por, për gjenezën e shpërndarjes masive të botimeve, strategjitë e përdorura, përpjekjet e njëkohshme për *Shkrimin e Shenjtë* dhe *shqipen e shkruar*, nuk është folur kaq gjerësisht përmes faktesh e dëshmish të shumta, duke plotësuar atë mozaik që nisi të zërë fill me zbulimet e prof. Xhevat Lloshit në Arkivat e Londrës, me punën e Xhon Kunarudit e të studiuesve të tjerë. Por, natyrshëm lind pyetja, se cili qe shkaku kryesor që i çoi këta përfaqësues në ndërmarrje kaq të mëdha, të cilat ndihmuan edhe në proceset e bashkimit kombëtar dhe të arsimimit në gjuhën amë dhe, në veçanti, të arsimimit të femrës shqiptare dhe të emancipimit të saj. Ajo çka i shtyu misionarët drejt trojeve të largëta gjeografike e kulturore, ishte pikërisht shpërndarja e Biblës në mbarë botën. Arritjet letrare të protestantëve në trojet shqiptare gjatë shek. XIX dhe XX qenë mbresëlënëse në disa aspekte, pavarësisht sfidave dhe kundërshtimet me të cilat iu desh të përballëshin ata nuk reshtën së përmbushuri misionin e tyre. Vala e botimeve që erdhi gjatë shek. XIX, nga shoqëri të tilla si Shoqëria e Broshurave Fetare (RTS, *Religious Tract Society*), parapriu zhvillimet e shpejta dhe shpikjet në fushën e botimit anembanë botës, si: shtypja, libërlidhja dhe shpërndarja (Woodbery, në: *American Political Review*, 2012). Në Shqipëri, shprehet D. Hosaflook, “kjo valë botimesh pati rrjedhoja kombëtare”. Figura të shquara të Rilindjes sonë Kombëtare u shprehën në periodikët e kohës për rëndësinë e pamatë të botimeve të BFBS-së dhe të RTS-së, të cilat dhanë ndihmesë domethënëse sidomos për çështjen e Pavarësisë. Vërtet para përpjekjeve të misionarëve të Shoqërisë Biblike pati botime në shqip, vepra të cilat sot njihen gjerësisht, por në fillimshekullin XIX, këto ose ishin në kopje të rralla, ose nuk njiheshin. (Dimë se disa prej këtyre libra u zbuluan vonë, krahasuar me vitbotimet që mbanin.) Në periudhën në fjalë, libri shqip nuk qarkullonte rregullisht dhe shpërndarja e tij ende nuk ishte prioritet i ndonjë botuesi. Kujtojmë se më 1824, botimi dygjuhësh greqisht–shqip i *Ungjillit sipas Mateut* nga BFBS-ja, i përkthyer nga Vangjel Meksi dhe i redaktuar nga Grigor Gjirakastri, hapi një udhë të re për shqipen e shkruar, edhe për faktin se do të shpërndahej kudo ku flitej shqip, duke e bërë atë “një gjuhë të gjallë dhe të përdorur” (M. Frashëri, *Diturija*, 1 janar 1909), ndërsa *Dhiata e Re* dygjuhëshe greqisht–shqip, më 1827, po nga dyshja V. Meksi dhe G. Gjirakastri, do të cilësohej pas 100 vjetësh si “udhëheqëse për shkrimin e shqipes” (M. Frashëri, *Diturija*, nr. 7, 1927).

Përpjekjet e njëkohshme e të pandashme, si dy anët e një medaljeje, të Shoqërisë Biblike për Shkrimin e Shenjtë dhe për shqipen e shkruar, parashtrihen në këtë libër tepër gjerësisht përmes faktesh e dëshmish, shumësyresh të pahulumtuara më parë në historiografinë shqiptare. Suksesi i misionarëve protestantë qe edhe se hapën pika/depo magazinimi – fillimisht në Shkodër e në Janinë – që të shërbenin në trojet veriore edhe ato jugore. Arsyeja e këtyre nismave të mëdha edhe për kombet e vogla qe tepër e thjeshtë e praktike, si dhe e lidhur ngushtësisht me objektivin e tyre kryesor: *lexueshmëria* e shkrimit të shenjtë. Nëse tashmë Fjala e Zotit mund të lexohej tashmë edhe nga



Botimi i Prishtinës, “Tenda”, 2019



Botimi i Shkupit, “ITSHKSH”, 2019

shqiptarët, si do të mund ta lexonin ata, kur shkalla e analfabetizmit qe tepër e lartë dhe shqipja ishte ende një gjuhë e palëvruar; kjo do të përbënte edhe arsyen pse ata u interesuan edhe për çështjet arsimore të shqiptarëve. Papërgatitja për leximin e botimeve do t'i çonte përfaqësuesit e Shoqërisë Biblike në zgjidhje të vështira e komplekse, siç ishin: zgjidhja e një sistemi sa më të thjeshtë drejtshkrimi (ai i Lepsiusit për shqipen), në mënyrë që të përdorej sa më lehtë nga një komb analfabet; zgjedhja e një alternative për alfabetin, duke qenë se shqipja kishte edhe tinguj të veçantë, kështu, me disa ndryshime për tingujt e veçantë ata përzgjedhën germat greke për botimet në toskërisht dhe germat latine për botimet në gegërisht; kultura editoriale dhe kujdesi në proceset e botimit; pasqyrimi i alfabetit të përdorur, si ndihmesë për shqiptimin e tingujve; reklamimet në pasballinë – kur teksti botohej në toskërisht reklamonte edhe tekstin gjegjës në gegërisht dhe e anasjella, çka mund të ndihmonte në unitetin kombëtar dhe leximin për çdo shqiptar, pa dallime krahinore. Kontribut të jashtëzakonshëm për shqipen e shkruar dha dyshja Alexandre Thomson dhe Konstandin Kristoforidhi. Për Alexander Thomson, shqipja e shkruar në fillim të shek. XIX qe një *tokë e panjohur (terra incognita)*, e për të, puna e BFBS-së pa mësuesit e alfabetit do të ishte bërë përgjysmë, prandaj ai e pa të udhës që bashkë me shkrimet e shenjta të botoheshin e të shpërndaheshin njëkohësisht dhe masivisht edhe abetaret e K. Kristoforidhit (1866, gegërisht dhe 1867, toskërisht). Për këtë, D. Hosaflook sjell në vëmendje të hulumtimit të tij veprimtarinë e pashlyeshme në historinë e zhvillimit të librit shqip të këtyre dy figurave, të cilët përmes angazhimit dhe projekteve të tyre nxitën ndër shqiptarë ndjenjat kombëtare, letrare, kulturore, fetare dhe arsimore,

jo vetëm në qytetet kryesore të Shqipërisë, por edhe në zonat më të thella të saj, pavarësisht vështirësive infrastrukturore po dhe sulmeve të kaçakëve, me të cilat u ndeshën plot misionarë. Sipas prof. Xhevat Lloshit, Konstandin Kristoforidhi e kishte përdorur Shoqërinë Biblike si një shtëpi botuese për qëllimet e tij kombëtare, sepse për të qe një zgjidhje e përshtatshme për depërtimin e librave shqip. Filozofia e misionarëve, e cila përshkruhet gjerësisht në raportet vjetore të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet në Vendet e Huaja (*American Board of Commissioners for Foreign Missions*, ABCFM), konsistonte në dy qëllime kryesore: *ungjillëzimin* dhe *arsimimin*. Prof. Xh. Lloshi thekson në parathënie, se: “...synimet dhe veprimtaritë konkrete të Lëvizjes Protestante janë përputhur me synimet kryesore dhe me veprimtarinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, duke e bërë këtë libër edhe një shpalosje të re të një ane të rëndësishme të Rilindjes Shqiptare”. Po ashtu, të angazhuar prej Shoqërisë Biblike qenë edhe anëtarët e familjes Qiriazi, të cilët nuk ishin vetëm veprimtarë aktivë në shërbim të çështjet kombëtare dhe të shkollave shqipe, por, e mbi të gjitha, ata ishin përgatitur për “të përhapurit” e Ungjillit edhe të shkronjavet shqipe ndë Shqipëri, me çdo farë mënyre të drejtë” (Kanonizma e Vëllazërisë Ungjillorëvet ndë Korçë). Përpos çështjes kombëtare, që gëlonte në periudhën kur jetuan dhe vepruan Qiriazët, ata paralelisht e pandërprerë i shërbyen ndriçimit *arsimor* dhe ndriçimit *shpirtëror* të kombit tonë.

Në librin *Lëvizja Protestante te shqiptarët*, ndër të tjera, flitet edhe për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës së Shoqërisë Biblike, për të botuar Shkrimin e Shenjtë në gjuhën shqipe dhe për angazhimin në këtë punë të shqiptarëve të aftë e të arsimuar jashtë vendit. Ata e panë të nevojshme të

harmonizonin disa procese zinxhirore, si: botimet në gjuhën shqipe, shpërndarjen masive të tyre, hartimin e abetareve, gramatikave e fjalorëve, themelimin e shkollave në gjuhën amë dhe emancipimin e femrës shqiptare – të gjitha këto, për të arritur në iniciativën fillestare, që ishte *përhapja e Fjalës së Perëndisë në gjuhën të cilën populli e kuptonte* – e kjo ishte gjuha amtare. Me këto përpjekje të vijueshme e me intensitet të lartë nga viti në vit, libri shqip po përhapej me shpejtësi në mbarë trevat shqipfolëse, duke krijuar kështu një këndvështrim bindës mbi vetë shqiptarët, çka shërbeu dhe i ndihmoi ata edhe në përforcimin e ndjenjës kombëtare. Botimet në gjuhën shqipe të Shoqërisë Biblike u shtypën në tirazh të madh dhe u shpërndanë, përmes rrjetit të *librashitësve shëtitës*, deri në skajet më të largëta të trojeve shqiptare, duke bërë që të rezultonte në strategjinë më të frytshme të kohës.

Edhe pse libri i D. Hosaflook fokusohet më së tepërmi në trajtimin e lëvizjes protestante te shqiptarët dhe te çështja e shkrimit të shenjtë në gjuhën shqipe, këto nuk mbeten trajtesat e vetme, përkundrazi, në të shqyrtohen gjerësisht e deri në shterim shumë çështje lidhur me Shqipërinë e shek. XIX dhe fillimshek. XX, duke rrokur në tërësi mjaft faktorë. Përtej vlerave profesionale në hartimin e librave të tillë, do të vlerësoja më së pari vlerat gjuhësore të autorit, në njohjen e në zotërimin e shqipes standarde – vlera të cilat janë tepër të lakmuara për vetë ne shqiptarët, kur bëhet fjalë edhe për përdorime të veçanta të trajtave të shqipes.

Përgëzime ISSHP-së (Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante) për këto botime të vyera që po shtohen radhazi në letrat shqipe; rëndësia e të cilave vërehet përmes pasqyrimin shkencor dhe dritësimit të një sërë të dhënash të historisë sonë, por edhe për vendin që zënë në historiografinë shqiptare.



TË DHËNA MBI AUTORIN

David Hosaflook u lind më 1970, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Menjëherë sapo kreu studimet universitare në vitin 1992, për teologji, ai erdhi Shqipërinë për një mision humanitar në ndihmë të jetimëve. Plani i tij ishte për të qëndruar në Shqipëri vetëm dy muaj dhe të vazhdonte studime pasuniversitare, por, si shumë të huaj, u rrëmbye nga dashuria për popullin shqiptar. Gjatë viteve të qëndrimit në Shqipëri ka punuar në disa qytete: Tiranë, Shkodër, Tropojë, dhe sot vijon në vitin e tij të 28-të në Ballkan.

Hosaflook-u është njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe dhe më 2012-n, në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë botoi për herë të parë në anglisht *Rrethimi i Shkodrës*, i autorit shqiptar Marin Barleti, duke bashkëpunuar me historianë të huaj për ta pajisur librin me shënime historike.

Më 2017, D. Hosaflook përfundoi studimet e doktoraturës në *Histori*, pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, të Universitetit të Tiranës. Pikërisht libri *Protestante te shqiptarët: 1816–1908* është varianti i botuar, me ndryshime të vogla, i disertacionit të tij, i cili u botua më 2019 në Shkup, nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, me mbështetjen e Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në Prishtinë, nga shtëpia botuese “Tenda”. Gjatë kohës së hulumtimeve për Lëvizjen Protestante, Hosaflook-u themeloi në Tiranë, më 2016, Institutin për Studime Shqiptare dhe Protestante. Aktualisht Dr. Hosaflook është drejtori ekzekutiv i tij, dhe ka ndërtuar një bibliotekë dhe arkiva burimesh me mijëra dokumente me interes për historinë e shqiptarëve po dhe të popujve të rajonit, duke ndriçuar e duke theksuar në veçanti shembujt e bashkëjetesës dhe harmonisë mes popujve të Ballkanit.

Disa nga titujt e botuar prej David Hosaflook

mund të veçonim: *Lëvizja Protestante te shqiptarët, 1816–1908* (2019), albumin *Libri shqip dhe veprimtaria protestante: 200 vjet rrugëtim kulturor/ The Albanian Book and Protestant enterprise: a 200-year cultural journey* (2017), *Albania and the Albanians in the Annual Reports of the British and Foreign Bible Society* (2017), *Albania and the Albanians in the Annual Reports of the American Board of Commissioners for Foreign Missions/ Shqipëria dhe shqiptarët në raportet vjetore të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet në Vendet e Huaja* (2017) etj.

Dr. Hosaflook ka organizuar disa konferenca shkencore me karakter rajonal ballkanik, përfshirë edhe *Konferencën Ballkanike me rastin e 500 vjetorit të Reformacionit Protestant* në Shkup. Ai është anëtar i disa institucioneve kulturore e shkencore në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut e Amerikë; organizues i ekspozitave në bashkëpunim me biblioteka kombëtare; kumtues dhe pjesëmarrës i përplot konferencave shkencore e kulturore; pjesëmarrës nëpër disa debate e prezantime publike në të gjitha hapësirat mediatike shqiptare në Ballkan, merret me përkthime librash, dhe në cilësinë e editorit dhe deri më tani ka përgatitur për botim mbi njëzet tituj veprash.

Më së fundmi, ai është nderuar me çmimin “Unsung hero in enabling integration of the Albanian community in the UK” (2020), në Londër, nga Shpresa Programme dhe me çmimin shtetëror të Maqedonisë së Veriut “22 Nëntori – Kongresi i Manastirit, Dita e Alfabetit”, për kontributin e dhënë në hulumtimin dhe studimin e Kongresit të Manastirit, e në veçanti për zbardhjen e fatit të familjes Qiriazi.

David Hosaflook është lektor për historinë e krishterimit e të qytetërimit europian dhe për filozofinë e religjionit. Ai vazhdon veprimtarinë e tij të predikimit të Ungjillit në bashkësi ungjillore dhe ftohet shpesh nëpër konferenca ndërkombëtare, që të jetë i pranishëm me kumtesat e tij.

OLGA TOKARCZUK

Gishti që tregon hënën

përgatiti dhe përktheu Prof. Arqile Teta

Në fillim të vitit 2009 (pasi botova Fjalorin Polonisht-Shqip në Tiranë, i cili ishte fjalori i parë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Poloni, me 25 mijë zëra dhe me shumë shembuj, shprehje frazeologjike e fjalë të urta) nga Instituti i Librit i Polonisë më erdhi një ftesë për të marrë pjesë në Kongresin Botëror të Përkthyesve të Letërsisë Polake që u mbajt nga 3 deri 7 qershor 2009 në Krakow nën kujdesin e Ministrisë të Kulturës dhe të Trashëgimisë Kombëtare të Polonisë.

Në këtë Kongres merrnin pjesë mbi 250 përkthyes të letërsisë polake nga të gjitha kontinentet. Shtetet dhe gjuhët europiane përfaqësoheshin me disa pjesëmarrës. Nga vendi ynë ishin ftuar përkthyesi i mirënjohur i polonishtes Astrit Beqiraj dhe unë. Veç përkthyesve të huaj, në Kongres binin në sy dhe personalitete të letërsisë polake: shkrimtarë dhe gjuhëtarë që lexonin në seksione të ndryshme ligjërata. Dalloheshin mes tyre poetja nobeliste Wisława Szymborska (W. Szymborska), poeti më në zë në atë kohë në Poloni e më gjerë Adam Zagajewski (A. Zagajewski), prozatorja e re e talentuar Olga Tokarczuk (O. Tokarczuk; lindur më 1962 në Sulechów, Silezi e Poshtme, Poloni) etj. Ligjërata e O. Tokarczukut më tërhoqi shumë se lidhej me gjuhën dhe në pushim iu luta ta fotokopjoja. Ajo me një buzëqeshje më pyeti me dashamirësi: “I pëlqeu zotërisë?” Ia pohova me kënaqësi. Ajo më dha tekstin origjinal të ligjëratës që ende e mbante në dorë dhe më tha: “Urdhëro, mos ma kthe... kam kopje tjetër.”

Vitet kalonin dhe Olga Tokarczuk bëhej gjithnjë dhe më e famshme jo vetëm në Poloni, por dhe në botë, derisa më 2018 fitoi çmimin Nobel në letërsi duke u bërë nobelistja e pestë e Polonisë në letërsi (pas: H. Sienkiewicz më 1905, W. Reymont më 1924, Ç. Miłosz më 1980 dhe V. Szymborska më 1996) dhe e shtata në plejadën e nobelistëve polakë (M. Skłodowska-Curie dy herë: më 1905 në fizikë dhe 1911 në kimi si dhe L. Vallensa çmimin për paqe më 1983).

Ligjëratën origjinale, me shënime me laps të shtuara nga vetë Olga Tokarczuk, atëherë shkrimtare e re, jo fort e njohur, e ruajta si kujtim të çmuar dhe relikti letrar se e çmova si një prozë e shkruar nga një talent që ishte ende në hapat e para të shkëlqimit në letërsinë botërore. Sot që ajo mban laurën e çmimit Nobel, po ia bëj të njohur lexuesit tonë.

Kuptimi i vetëdijshëm nga njeriu i gjuhës së vet, me të gjitha dhuntitë e saj, me dobitë e përfitimet, si dhe me kufizimet e trillet, të krijon përshtypjen e një psikanalize të tejzgjatur. Ajo nxjerr në pah gjithë bagazhin që mbartim jo për arsye të gabimeve e fajeve, apo meritave tona, por për arsye që u lindëm në një vend, në një kohë apo në një formë. Pra, në njëfarë kuptimi gjuha është një fat i pashmangshëm letrar. Ajo gjithashtu tregon si pëllëmba e dorës se në gjuhë vetëm deri në njëfarë shkalle mund të jemi vetvetja (dhe “të jesh vetvetja” do të thotë të jesh vërtet një postulat i kulturës sonë), ndërsa në një shkallë të madhe i nënshtrohem asaj, e cila është më e rëndësishme, më e fuqishme se ne dhe mbi të cilën nuk kemi ndikim.

Nuk ka asgjë të çuditshme që filozofët së fundi lanë pas dore Hyjninë, Qenien, Pse më Mirë Diçka se sa Asgjë dhe u morën me gjuhën.

Shkrimtarët shpesh bëjnë gabim duke e trajtuar gjuhën si domenin e tyre të lirisë, kur në oqeanin e madh të zanafillës, aminoacidet e para formulojnë mendimet tona individuale dhe mënyrat e shprehjes. Pra, duket se akset e kristalizimit u vendosën dhe ne nuk kemi ndikim mbi to. Kuptohet që në gjuhë jemi të hedhur.

Unë u hodha në polonishte. Linda dhe u rrita në tokat perëndimore të Polonisë që u bashkuan me pjesën tjetër të vendit pas luftës dhe u banuan me përzjerjen e madhe të pasluftës të kulturave dhe dialekteve polake. Në këtë furrë shkrirjeje, siç theksojnë gjuhëtarët, u krijua modeli i polonishtes dhe ka të ngjarë që ne në Silezinë e Poshtme flasim polonishten standarde. Nuk flas me shprehje e huazime të ndonjë dialekti dhe me asnjë theks. Nuk di aq mirë asnjë gjuhë tjetër, saqë të mund ta trajtoj atë si gjuhë të letërsisë që shkruaj. Jam, pra, njëgjuhëshe. Nuk do të mund të shkruaja në një gjuhë tjetër. Mund të komunikoj në dy gjuhë të tjera, por vetëm në një bisedë të thjeshtë dhe në njëfarë kuptimi kjo është e dhimbshme. Mund të vendosem në Sevres pranë Parisit, atje ku mbahen të gjitha shabllonet, si shembull i personit polonishtfolës në mënyrë të përsosur. Qëndroj në polonishte si miza në qelibar.

Polonishtja bën pjesë në grupin e madh të gjuhëve sllave; rrjedhimisht, në familjen indoeuropiane. Në shkrim filloi të formohet mjaft vonë, përndryshe në shekullin XII. Marrja e krishterimit nga Roma dhe jo nga Bizanti pati një rëndësi të madhe – i lejoi polonishtes të hyjë në sferën e kulturës latine dhe të marrë alfabetin latin (siç dihet, disa gjuhë sllave morën për bazë për alfabetin e tyre atë grek – për shembull rusishtja apo bullgarishtja). Vetëm më 1270 në Librin e Henrikovës, të hartuar, në fund të fundit, në Silezinë e Poshtme, u shkrua fraza e parë polonisht dhe kjo në një kontekst mjaft interesant. Teksti latin tregonte me pak fjalë për një farë Boguchwale i cili – për bashkëkohësit dukej si diçka e pazakontë, aq sa t’ia vlente të shkruhej – ndihmonte gruan në bluarjen e drithit. Pikërisht ai tha frazën e parë të famshme: “Day ut ia pobrusa a ti pożywai”, që në polonishten e sotme do të thotë: “Më lejo ta bëj unë këtë dhe ti pusho.”

Shtirja gjeografike e Polonisë, ndërmjet dy fqinjëve të fuqishëm në mes të Europës, në afërsi të kulturave të ndryshme, ka ndikuar që në polonishte të depërtojnë shumë fjalë të huaja. Leksiku i polonishtes përmban deri 70 për qind fjalë të huazuara nga gjuhët e tjera, gjë që është e rrallë në sfondin e gjuhëve të tjera. Pra, është një gjuhë e përbërë, gjuhë e kompozuar me arnishte, furrë shkrirjeje dhe përzjerjeje. Kemi marrë fjalë nga fqinjët – për shkak të veprimtarisë tregtare që kemi bërë me ta, të luftërave, të udhëtimeve, të modës dhe magjepsjes pas së bukurës. Gjermanëve u jemi mirënjohës për terminologjinë e pasur teknike. Çdo risi depërtoi te ne përmes fqinjëve perëndimorë, me të cilët kemi pasur gjithashtu shumë probleme – ngulimet gjermanike në tokat polake kanë qenë gjithmonë një grup i fuqishëm ekonomik, i organizuar mirë. Në shekullin XIV, për shembull, përbënin 80 për qind të aristokracisë krakoviane, çka e detyroi mbretin polak të përdorë kundrejt tyre një test të posaçëm gjuhësor – për të gjetur gjermanët e pabesë, të cilët ngritën një rebelim në Krakov, duke i urdhëruar të shqiptonin fjalët që vijnë: *soczewica*, *kolo* i *miele młyn* (thjerrëza, rrota dhe mulliri bluan). Ata që nuk dinin t’i shqiptonin në mënyrë të përpiktë – ndëshkoheshin. Së bashku me

mbretëreshën Bona mbërritën në Poloni shumë fjalë italisht, kryesisht nga fusha e arkitekturës, e muzikës, e artit ushtarak dhe para së gjithash, nga kulinaria. Në shekullin XVII ndodhi zbarkimi i frëngjishtes. Ndikim të madh ka pasur edhe gjuha ruse dhe gjuhët e tjera të Lindjes. Madje, mund të krenohemi me hyrje të turqizmeve dhe fjalëve të hungarishtes. Latinishtja shtoi polonishten me fjalë e shprehje nga fusha e shkencës, e koncepteve abstrakte dhe fetare. Në shekujt XV dhe XVI ishte e modës çekishtja dhe kishte opinion të mirë ai që tregonte në një shoqëri të lartë njohje të çekishtes. Gjatë shumë viteve të pushtimit u bë në mënyrë aktive dhe shumë intensive gjermanizimi dhe rusifikimi. Sot – si gjithkund në botë – ka kaluar në mësymje anglishtja.

Mua më pëlqen hapja e polonishtes kundrejt fjalëve të huaja – dhe të mos shqetësohem, asaj nuk i kanoset asnjë rrezik; në shtjellën e papërmbajtur që ajo krijon edhe fjalët e huaja me shqiptim të largët për të, përfshihen në mullirin e fuqishëm të gramatikës së polonishtes, sepse ngjiten tek ato mbaresat e saj të veçanta dhe kalandrohen nga lakimi përmes rasave.

Megjithatë, kjo gjuhë e kompozuar me arnishte ka përmbushur rolin e jashtëzakonshëm e paradoksal – në periudhën shumëvjeçare të okupimit nga pushtuesit u bë shtyllë e identitetit kombëtar, kurse letërsia, që u krijua në këtë kohë, ishte i vetmi vend i mbijetesës të kulturës polake. Për gjuhën polonisht u luftua, për të folur polonisht u flijua edhe jeta. Sot është vështirë ta përfytyrosh këtë.

Për shkrimtarin funksionin ndihmës të psikanalistëve e kryejnë shpesh përkthyesit – ata bëjnë pyetje nga më të habitshmet. Do të duhej të mbaheshin shënim, të ruheshin dhe të botoheshin në tirazh të veçantë, që lexuesit të kishin mundësi të çmonin mrekullinë e të shkruarit dhe silitjen e përkthyesve. Falë tyre, ajo që më dukej e natyrshme dhe e përgjithshme papritmas humb kohezionin e saj të brendshëm dhe bëhet joreale dhe krejtësisht lokale. Janë pikërisht ata që më drejtuan vëmendjen në disa karakteristika të polonishtes, të cilat po i tregoj më poshtë. Të gjithë të njohurit e huaj, këta njerëz të guximshëm, të cilët vendosën të mësojnë polonishten, kanë të njëjtën gjë. Ata ankohen shpesh se gramatika e polonishtes përbëhet kryesisht nga përjashtime, se duhet të mësojnë rregulla të vështira, të cilat në çast bëhen të pavlera nga sasia e madhe e përjashtimeve të mundshme. Kjo është e vërtetë – në polonishte ndoshta më mirë është të hysh me intuitë sesa të mësosh përmendsh. Polonishtja është një gjuhë, e cila vëmendjen ia kushton traditës dhe trajtave historike, është gjuhë-muze – plot me fosile, të cilat nuk është e mundur t’u nënshtrohen parimeve të pragmatizmit. Lakimi dhe zgjedhimi i ndërlikuar jo vetëm që shton dhe heq mbaresa, por ndryshon edhe rrënjën e fjalës. Kemi kohën e ardhshme të aspektit të kryer dhe të pakryer të foljes, e cila demaskon madje dhe gjermanin që flet më mirë polonisht. Në drejtshkrim ekzistojnë disa tinguj të njëjtë, që shkruhen në mënyra të ndryshme sepse në të shkuarën i shqiptonin ndryshe dhe mbetën në gjuhë si kujtim që mbjellin panik te gjimnazistët.

Gjuha polonishte nuk është as gjuhë logjike as pragmatike. Gramatika e saj është kërkuese, madje e marrosur, drejtshkrimi i vështirë. Me gjithë plasticitetin leksikor, mban për arsye jologjike (mundet pra sentimentale) trajta të vjetra tradicionale gramatikore dhe drejtshkrimore.

Është gjithashtu gjuhë tradicionale edhe për një arsye tjetër – është mashkullorecentriste. Ndërmjet tri gjinive që disponon i jep pozicion të privilegjuar gjinisë mashkullore. Emrat e gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjane ndryshe lakohen në vetë, rasë, ndërsa foljet zgjedhohen ndryshe në kohë për gjininë mashkullore dhe femërore. Ndër to sundojnë edhe mjaft përjashtime. Për meshkujt themi se: *poszli* (poshli = shkuan). Për femrat themi se: *poszły* (poshlli = shkuan), ndërsa për një grup të përzier me femra dhe

meshkuj – gjithmonë duhet thënë “në mashkullore” – *poszli*.

Ky parim vepron edhe atëherë kur në një grup po themi prej gjashtëdhjetë femrash ndodhet një mashkull, prania e tij na detyron të përdorim trajtën mashkullore për gjithë grupin – *poszli*. Femrat, fëmijët dhe kafshët do të përfaqësohen në këtë rast nga forma femërore. (*Me shkrim dore e laps është shtuar*: si tualetet në aeroporte... *Fraza vazhdon, por është krejtësisht e palexueshme A. T.*). Për meshkujt është e rezervuar kjo e privilejuara – mashkullore. Natyrisht, vetë fjala njeri – njëlloj si dhe në gjuhët e tjera – është e gjinisë mashkullore. Duke folur, pra, në mënyrë të përgjithshme për njeriun do të përjashtojmë gramatikisht nga ajo fjalë femrat (dhe fëmijët). Ky patriarkalizëm pasqyrohet gjithashtu dhe në emrat e profesioneve. Gjuhët e tjera ia kanë dalë mbanë (si për shembull gjermanishtja), ndërsa në polonisht vazhdimisht me këtë ka telashe e siklete. Emrat femërorë të profesioneve thuhën në polonisht në trajtën zvogëluese të mashkullores, gjë që shkakton përshtypje joserioze dhe fsheh me siguri një kuptim përçmues të thellë – femra profesor – profesorka (*profesoreshë A.T*) – tingëllon si profesor mashkull i vogël (profesorek).

Nga natyra mashkullorecentriste e polonishtes shumë herë jam ndeshur me thënien *pisarka* (*shkrimtarja A. T.*) (që është trajta femërore e “*pisarz*” (*shkrimtar A.T.*). Në polonisht, siç dihet, nuk mund të lihet mënjane gjinia e atij që shkruan, kur përdoret veta e parë. Gjinia është menjëherë e dukshme në foljet e kohës së shkuar, kurse në të tashmen e mënjanon atë trajta femërore e mbiemrave. Nga kjo nuk mund të ikim. Ka pasur telashe përkthyesja e librit të Jeanette Winterson, ku në mënyrë konsekuente përdoret veta e parë e kohës së tashme, që ia ka dalë të fshehtë gjininë e tregimtarit/res, çka ishte thelbi i këtij romani. Ishte e pamundur të shkëputej “nga gjinia” dhe arbitrarisht i duhej t’i përshtatej gjinisë së asaj/ atij – në këtë rast femërores. Meqë erdhi fjala, ju kujtoj se polonisht “mother tongue” është “father tongue”, “język ojczysty” (*gjuhë atërore A.T.*).

Polonishtja, sikurse edhe gjuhët e tjera sllave, përmban në vetvete një potencial të madh në sferën e fjalëformimit, veçanërisht arrin të krijojë në përmasa të mëdha shumë trajta zvogëluese, gjë që sjell një shkëputim gjuhësor. Për mua kjo është një dukuri e ngrohtësisë gjuhësore, kategori që është lënë pas dore në tekstet e gramatikës. Kjo është veti e gjuhës që në mënyrë të papërsëritshme dhe magjike e bën botën të rehatshme dhe të sigurt. Askënd në Poloni nuk e çuditin fjalët e këngës popullore për ushtarin që shkon në “wojenkę” me “szabelkę” në brez, sipër mbi “koniku” (“wojenkę” *trajta përkëdhelëse ose zvogëluese e fjalës wojna=luftë*; “szabelkę” *zvogëlim i fjalës szabla=shpatë*; “koniku” *zvogëlim i fjalës koę=kalë A.T.*). Mënyrat e përdorimit të trajtave zvogëluese apo përkëdhelëse janë të shumta dhe çdo emër njeriu mund t’i nënshtrohet këtij trajtimi. Po kështu mund të bëhet dhe me çdo emër dhe mbiemër gramatikor.


Deri në Luftën e Dytë Botërore Polonia ishte vend shumëkulturësh dhe shumëgjuhësh dhe për këtë jemi krenarë. Atje ku polonishtja u takua me gjuhë, ndjeshmëri e mendësi të tjera – atje ajo ishte më krijuese. Nuk është fare rastësi që mjeshtrit e gjuhës polonisht kanë dalë nga periferia e Polonisë. Kështu është proza mahnitëse dhe e papërsëritshme e Bruno Schulz-it që u krijua në kontaktin polako-hebraik-ukrainas. Po kështu poezia figurative dhe e pasur e Czesław Miłosz-it, i cili e kishte prejardhjen nga Vilna, apo absolutisht përrallore, por fatkeqësisht e vështirë në përkthim, polonishtja e Bolesław Leśmian-it dhe e Julian Tuwim-it nga kufiri hebraik-polak.

E epshme, e figurshme, e mjegullt, jo fort e përpiktë, tradicionale dhe gramatikisht e pallogaritshme... Më tepër e krijuar nga intuita sesa nga arsyeja, më tepër për poezi sesa për disertacion shkencor. Kam përshtypjen se nuk ndihet mirë në një diskutim

intelektual as në tregimin realist linear të ngjarjeve. Dëshiron forma të hapura, shumëkuptimëshe. Është e ndjeshme ndaj groteskut dhe absurdes. E prirë nga patosi. Nuk është e çuditshme që poezinë e kemi të njohur dhe të vlerësuar në botë. Kjo është gjuhë, në të cilën lejohet shumë, gjuhë, e cila më shumë skicon botën se sa e përshkruan, gjuhë-impresjonisti, e aftë të shprehë përshtypje, gjendje shpirtërore, parandjenja, e hapur në lidhje e shoqërimi duke ndërtuar tablo. Më duket se Flaubert (*Flober*) ngulte këmbë se gjuha pëson dështim kur fillon të krijojë tablo; pasi atëherë largohet nga vetvetja dhe rrëshqet në anakronizëm. Nuk jam dakord me këtë konstatim. Gjuha është më e fuqishme atje ku del jashtë vetvetes dhe bëhet krijuese e botës alternative, kur, sikurse iluzionisti nxjerr nga kapela sende të cilat nuk do të kishim ditur madje

mirënjohëse këtij fati të pashmangshëm gjuhësor?

Polonishtja hyn paradoksalisht në gjuhët e ashtuquajtura të vogla, megjithëse atë e flasin në botë mbi 50 milionë njerëz (duke numëruar edhe emigracionin e madh polak). Ajo është gjuhë lokale, periferike e aq më tepër e vështirë dhe largon nga vetja shumë njerëz. Vetë e këtyre gjuhëve të “vogla” – veçanërisht kur njeh dhe ato të “mëdhatë” – është mundësia e strehimit, arratisjes në gjuhë dhe vendosja në një vend pak të shkelur dhe të paarrtshëm për pjesën tjetër të botës. E njoh nga e kaluara këtë përvojë të fshehjes në polonisht në aeroportet e mëdha botërore, larg kufijve të vendit, kur mund të ishim të sigurt se askush nuk na kuptonte ne që flisnim polonisht. Sot është ndryshe. Emigracioni i madh polak në vitet e fundit e ka lejuar polonishten të shtrihet së



as t’i imagjinonim. Polonishtja për mua është gjuhë arkaike, e cila i përgjigjet botës para diferencimit të saj, kur gjithçka ka të ngjarë të ishte më kompakte, më e perceptueshme nga shqisat, kur ekuilibrohej në intuita dhe “çfarë” ishte më e rëndësishme se “si”. Gjuhën e trajtoj si – le të marrim këtë krahasim oriental – gishti, që tregon hënën. Nuk përmbahem për gjuhën.

Ndjeshmëria ime deri në njëfarë mase kureshtare, perceptimi im dhe të menduarit u trajtësuan nëpërmjet polonishtes së vështirë, pak precize, por shumë figurative. A do të mund të shprehja ato që aq shumë më preokupojnë në të shkruar – intuitën, gjendjen shpirtërore, shqetësimin, i cili më zë pritë duke nxjerrë si arsye konstante sigurinë e formimit të ndodhive në një gjuhë tjetër. Mbase detyrohem t’i jem

bashku me të gjerësisht në botë, por nuk mendoj se do të mund të ndikojë kjo në shtrirjen e përgjithshme ndër të huajt. Ka të ngjarë që do të duhet të mësojmë me zell anglishten dhe kjo do të jetë mënyra për të komunikuar me botën. Shenjë e kapërcimit të kufirit do të jetë bar-kafeja më e afërt dhe pyetja e kamerierit “kaweczka” (*trajta përkëdhelëse e fjalës kawa=kafe A.T.*) të jetë me “mleczkiem” (*trajta përkëdhelëse e fjalës mleko=qumësht A.T.*). Gjithashtu mund të dëgjojmë përshëndetjen e fatorinos polak, që thërret gëzueshëm “Bileciki do kontroli!” (*Bileciki trajta zvogëluese e fjalës biletat; kontrolli i biletave A. T.*).

(Kjo ligjëratë u mbajt në Universitetin e Baptistëve në Hong-Kong).



HENRIK IBSEN PËRBALLË MAKSIM GORKIT

Si u bë poezia *Zgalemi* prozë poetike –
Kënga e Zgalemit apo Lajmëtari i furtunës

Dr. Hysen Kobellari

1

Në përgjithësi, të gjitha gjërat thelbësore të kësaj bote janë thënë qyshkur; dokumentimi është i fiksuar nëpër libra, përveçse në memorien e njerëzve. Njerëzve të brezave me radhë u pati mbetur t'i përsëritnin në forma, mënyra, trajta e gjendje të ndryshme ato që, në thelb, janë të njëjta prej mijëra vjetësh, duke shpaluar detajet vetjakësore që janë të pafundme. "Ne jemi në një epokë ku të gjitha fjalët tanimë janë thënë". (S. Averincjev, kulturolog rus) Ne përtypim dhe ripërtypim gjëra të njohura e të stërnjohura me kohë...

Dituria mbarënjëzore i ngjan një muri vigan me një pafundësi gurësh të vendosur përkrah e përmbi njëri-tjetrit që, duke u parë nga larg, duket monolit e mitik, ndërsa kur i afrohesh bëhet interesant, i bukur,

shpirtërisht i afërt për gjithkënd e ku rrahin miliona zemra e mendime njerëzish të gjallë...

Kultura, artet dhe letërsia janë ndërtesa vigane, gurët e të cilave kanë bazamente të forta nga epoka në epokë, që i mban gjallë komunikimi, dhënie- marrja mes veti, duke bërë edhe riformësimin dhe rikrijimin... Një krijim i ri është si një gur që vendoset mbi supet e një të vjetri, që merr nga bazamenti gjithçka të mirë që i duhet, me mundësinë që të japë për atë që do të vendoset së shpejti sipër tij. "...ne shohim më larg se paraardhësit tanë, jo se kemi vështirësi më të mprehtë apo se jemi më truphedhur, por se jemi ngjitur dhe qëndrojmë lart mbi shtatin e tyre vigan". (Xhoni i Salizburit, që i referohet Bernardit të Shartës)

1.1

Në botimet e shumta letrare, në krijimtarinë e shpërndarë dendur në rrjetet sociale, ka shumë ankesa të vazhdueshme të krijuesve për kopjime flagrante të krijimtarisë së tyre ose të të tjerëve, duke i quajtur ato plagjiatura, imitime, epigonizma etj. "Gjuha, që është ligjërimi më i vjedhur zakonisht prej mitit, bën një qëndresë të dobët". (R. Barthes)

Plagjiaturë vjen nga latinishtja *plagium* – kusari, vjedhje, hajni, hajdutëri; imitacioni – diçka e njëlojtë me diçka tjetër, e cila është marrë si gjedhe, kopje e origjinalit; epigon vjen nga greqishtja – i paslindur... Dukuri të tilla janë shfaqje të zhvillimit kulturor e letrar të kohërave, të kryera me vetëdije apo jo të krijuesve përkatës, akuzues dhe të akuzuar. Marrëdhëniet ndërkohore, me rimarrje e rishkruarje motivesh të njëjta prej mitesh, legjendash, folklorit etj., janë të njohura tashmë. Mjafton që krijimtaria e prurë të sjellë kënaqësi estetike dhe njeriu të mësojë diçka të re prej saj...

Gjithçka që shkruhet e krijohet e ka një burim, nga diçka paraekzistuese; kush nga mitet, dikush tjetër nga ngjarjet historike, nga realiteti, nga librat e tjerë. Kujtojmë *Iliadën* e *Odisenë*, *Komedinë Hyjnore*, veprat e Shekspir etj. Ku qëndron e reja që sjell një autor i vërtetë?! Sipas Horacit, e reja "...nuk qëndron në risinë e argumentit, por në *proprie dicere* (shprehjen e posaçme) në njoftimin origjinal, pra të ri, me karakteristikë personale".

1.2

Për të shpëtuar nga akuzat për plagjiaturë, imitacione, epigonizma etj., prej vitesh autorët janë orvatur të krijojnë me ose pa vetëdije rryma letrare nga më të ndryshmet, si simbolizmi, deri te modernizmi, postmodernizmi, për të qenë sa më "origjinalë" në krijimtarinë e tyre. Kjo, sipas tyre, bën diferencën. Realizmi u quajt i thjeshtëzuar, banal... Por, gjithsesi, komunikimi midis teksteve në letërsi nuk mund të mënjanohet kurrë plotësisht me procedime të tilla, si: ironia, parodia, analogjia etj. "Teksti është një kombinatorë, vend i një shkëmbimi të vazhdueshëm ndërmjet copëzash që shkrimi i rishpërndan duke ndërtuar një tekst të ri nga tekste të mëparshme, tekste këto të shkatërruara, të mohuara, të rimarra". (Julia Kristeva)

Si ta kapërcejmë prirjen tonë për të qenë imitues ose epigone të paraardhësve tanë?! "Antidoti ndaj yshtjes për të imituar dhe për të kopjuar krijimtarinë e tjetrit, *profilaksia* ndaj epigonizmit, kërkon thellimin në erudicionin individual kulturor, leximin sistematik, leximin e vazhdueshëm, thellimin në arritjet e më të mirëve, punë këmbëngulëse dhe të palodhur për të gjetur vetveten, individualitetin e vet, kërkon një ndjenjë përgjegjësie ndaj lexuesve dhe patjetër, sedër dhe moral, etikë shembullore personale". (V. Ziko)

Në *Kuriozitete estetike* Sharl Bodleri nënvizoi: "Artisti, artisti i vërtetë, poeti i vërtetë, duhet t'i paraqesë gjërat ashtu siç i sheh dhe siç i ndien vetë. Ai duhet t'i qëndrojë besnik natyrës së vet. Duhet të ruhet si prej vdekjes për të mos marrë sytë dhe ndjenjat e një tjetri, sado i madh qoftë ky; se atëherë arti i tij do të jetë gënjeshtër."

1.3

Mund të jepen me mijëra shembuj se si edhe vepra shumë të suksesshme të letërsisë e kanë një burim të sigurt ardhjeje. Midis të tjerash, nga këto burime mund të veçojmë dy: vepra të autorëve të tjerë dhe vepra pararendëse të vetë autorit. Në literaturë gjen plot shembuj se si veprat e Homerit, Shekspir etj., vijnë nga mitet apo kronikat e kohërave të shkuara. Për rimarrje nga veprat e mëparshme shëmbëllojnë *Pallati i ëndrrave*, *Piramida* të I. Kadaresë; romani *Oh* i A. Pashkut nga tregimi *Eklipt* i tij etj. "Krijimi i ri relevon poetin! Krijimi i ri prej lëndës së vjetër..." (L. Poradeci)

2

Duke studiuar krijimtarinë e shkrimtarit norvegjez Henrik Ibsen (1828-1906) më ranë në dorë një tufë vjershash interesante, ku bënte pjesë edhe poezia *Zgalemi*. Sapo e lexova, m’u kujtua proza e famshme poetike e M. Gorkit (A. M. Peshkov, 1868-1936), *Kënga e Zgalemit* ose *Lajmëtari i furtunës*, që e mësuam përmendësh që nga fëmijëria. Dhe vura re ngjashmërinë e madhe në përmbajtje midis këtyre dy krijimeve. Nisa të meditoj, pa e shkuar në mendje të fajësoj ndokënd, duke e quajtur këtë fenomen si *përvetësim krijues*...

Të dyja tekstet fillojnë me përshkrimin e zogut zgalem, “zog i qiejve dhe i detit”... Dhe arsyetimet vazhdojnë.

2.1

Zgalemi i H. Ibsenit duket se është një vjershë e thjeshtë peizazheske-filozofike, me tone lirike, e ngjeshur në ide e domethënie, e shkruar në distikë (vargje dyshe), që bazohet në rrëfimet e një detari dhe që e krahason zgalemin në fund me “zogu-poet”.

Kënga e Zgalemit e M. Gorkit, që është konsideruar edhe si *Lajmëtari i furtunës*, është po i njëjti peizazh, veçse më i larmishëm dhe më i zgjeruar në përshkrim. Aty Gorki ka futur shpirtin e vet rebel, kryengritës. Elemente shtesë janë vetëm shpendët e tjerë “inferiorë” në breg të detit, si çafkat, kredharakët e frikur, pinguini...

“Zgalemi i Gorkit është shpirti i atij njeriu që nuk mund të gjejë paqen në vulgaritetin e jetës, që nuk frikësohet si çafkat dhe as nuk fshihet si pinguini, por lufton e përballlet me jetën duke synuar lirinë”. (K. Stralla) Kjo prozë poetike komentohej dendur si thirrje e autorit për rebelim, në funksion të një ideali madhor, – komunizmit, – ideal utopik që ia hëngri kokën vetë autorit, pasi shkrimtari nuk e kuptoi atëherë se ky ideal nuk pati kurrë idealistë që ta vinin në jetë...

2.2

Duke qenë edhe vetë dramaturg, shkrimtar i shumë dramave interesante, M. Gorki e ka njohur me themel krijimtarinë e H. Ibsenit, kur ishte për disa vjet syrgjyn në Itali. Rrjedhimisht, e ka lexuar edhe vjershën *Zgalemi* të norvegjezit të talentuar, prej nga e ka marrë edhe motivin shkrimor e shpirtëror. Edhe nëse nuk e ka pohuar se nga kush e ka marrë motivin, frymëzimin për të shkruar prozën poetike aq të njohur të tij, nuk mund të themi se ai është plagjiat, imitues apo epigon. Duke qenë shkrimtar i mirë, Gorki nuk mund të quhet një kopjac i rëndomtë. Krijimit të tij ai i ka dhënë frymën gorkiane, e ka sjellë në kohën e vet dhe e ka veshur me fizionominë përkatëse. E ka ngritur artistikisht. Autorët marrin e japin me njëri-tjetrin, në frymë e në germë, mjafton që kjo marrëdhënie të jetë në dobi, në të mirë të letërsisë e të kulturës së mbarë njerëzimit...

2.3

ZGALEM m. zool.

1. Shpend uji me pendë të bardha e të zeza, me krahë të ngushtë e të gjatë, me këmbë shumë të shkurtra, me bisht të bigëzuar dhe me sqep të kthyer, që fluturon mbi valët përpara e gjatë stuhisë. Zgalemi i stuhisë. Klithma e zgalemit. I guximshëm si zgalemi.

2. fig. poet. Paralajmërues i një lëvizjeje a i një ngjarjeje të madhe shoqërore. Zgalemi i revolucionit.

ZGALEMI

Nga Henrik Ibsen (1828-1906), përkthyer nga Shpëtim Çuçka

“Zgalemi jeton në shkëmb e në gur”,
më tha një detar i vjetër dikur.

“Mes shkumës me krahë shkëlqen e këlthet,

nuk mbytet jo kurrë, mbi valë rrëshqet.

Luhatet ngadalë mbi det’n e pamatë,
heshton në bunacë, këlthet në shtrëngatë.

Her’ zbret rrafsh me valët, her’ ngrihet përpjetë,
porsi ëndrrat tona nga toka në retë.

I rëndë në ajër, i lehtë në det,
ja gazi, ja vreri, ja zogu-poet”.


1858

KËNGA E ZGALEMIT

Kënga e Zgalemit ose Lajmëtari i furtunës, e shkruar nga Maksim Gorki (A. M. Peshkov, 1868-1936), përkthyer nga Lame Kodra (Sejfulla Malëshova)

Mbi të thinjurin shesh të detit era fryn dhe mblidhen retë. Midis reve edhe detit kryelartë shkon Zgalemi si e zezë vetëtimë. Prek me krahë ai valët, si shigjetë ngjitet reve, dhe këlthet, dhe retë gjegjin gazin-klithmë të asaj shpese. Në atë klithmë e atë furtunë, Zjarr e flakë zemërimi dhe besimi në fitore gjegjin retë në atë klithmë. Dridhen çafkat e rënkojnë, përmbi detin përpëlitën; janë gati ato të struken nga ky tmerr në fund të detit. Përpëlitën, si dhe çafkat, kredharakët e rënkojnë; nuk dinë ata të mjerët gëzim

lufte, luftë jete; i tmerron ata gjëmimi.
Ndër shkëmbinj mbulon i trembur trupn’ e majmë pinguini...
Ngrihet vetëm kryelartë, me guxim, lirisht Zgalemi mbi të thinjurin det nga shkuma.
Gjithnjë më tepër ngryset, gjithnjë më poshtë zbresin përmbi detin retë e zeza dhe këndojnë e hidhen valët lart e drejt nga vjen rrufeja.
Bubullon. Rënkojnë valët: në atë shkumë zemërimi po luftojnë ato me erën. Turma valësh rrëmben era, i mbërthen ajo me forcë, i përplas me vrull shkëmbinjve, duke bërë çika-çika ato masa prej zumrudi.
Po me klithmë shkon Zgalemi, si e zezë vetëtimë, si shigjetë i përpin retë, shkumën valësh heq me krahë. Si demon, ai vërtitet, madhështor e kryelartë ky demon i zi rrebeshi; qesh e qan ai njëherësh...
Qesh me retë, qan prej gazit.
Në tërbimin e gjëmimit lodhje sheh e ndien demoni; ka besim zogu i furtunës; retë-diellin dot s’e fshehin!
Era fryn me ulërimë... Bubullon e shkrepi rrufeja...
Ndizen retë flakë e kaltër përmbi detin si greminë. Kap shigjeta vetëtimash dhe në gji i shuan deti. Si gjarpërinj të zjarhtë dridhen mu në det e zhduken thellë pasqyrimet e atyre vetëtimave shigjeta.
Ja furtuna! Vjen furtuna!
Kryelartë e trim Zgalemi shkon me vrull ndër vetëtima përmbi detin e tërbuar, që buçet me ulërimë, dhe këlthet-profet fitoreje:
- Sa më tepër e fuqishme le të ngrihet lart furtuna!





“PO ÇMENDEM PËRSËRI”: RRËFIMI TRAGJIK I VETËVRASJES SË VIRGINIA WOOLF-IT

Hannah McKennett

Letra e vetëvrasjes së Virginia Woolf-it dhe vendimi fatal për të hyrë në lumin Ouse me gurë në xhepa, vetëm sa fillojnë të na tregojnë historinë e vdekjes së saj të trishtë. Veprat e shumta të shkrimtares angleze vazhdojnë të ndikojnë në kulturën moderne edhe pas më shumë se një shekulli pasi u shkruan. Ndërsa romanet e vlerësuara, si *Zonja Dalloway*, dhe esetë e njohura feministe, si *Një dhomë më vete*, mbeten joshëse edhe sot e kësaj dite, ashtu ndodh edhe historia e vetëvrasjes së saj, kur një ditë në fillim të pranverës së vitit 1941 ajo mbushi xhepat me gurë dhe u zhyt në një lumë pranë shtëpisë ku banonte. Por pas rrëfenjës për vdekjen është historia e paharrueshme e një gruaje e cila luftoi me tragjedinë dhe sëmundjen mendore gjatë

pjesës më të madhe të jetës, më së fundi duke iu nënshtruar mendimeve të saj pikëlluese.

GRUAJA PAS TRAGJEDISË

Lindur më 25 janar 1882, Virginia Woolf-i (me emrin Adeline Virginia Stephen) ishte me status të veçantë. Prindërit, sër Leslie Stephen dhe Julia Stephen, ishin personalitete të shquara në komunitetin e tyre në Londër. Të dy ishin shkrimtarë, Leslie punonte si redaktor i Fjalorit të Biografisë Kombëtare dhe Julia kishte shkruar një libër për profesionin e saj, infermierinë. Woolf-i dhe e motra, Vanesa, u shkolluan në fillim në shtëpi në bibliotekën e madhe të babait.

Shumë shpejt, të dyja studiuuan në King's College London, në departamentin për zonjat me titullin “Ledi”.

Pas diplomimit, Woolf-i u përhum b sakaq në botën e letërsisë, duke iu bashkuar një rrethi artistësh dhe intelektualësh të njohur si Grupi Bloomsbury. Këtu takoi bashkëshortin e ardhshëm, eseistin Leonard Woolf. Menjëherë pas martesës në vitin 1912, çifti bleu një shtypshkronjë, Hogarth Press, dhe botuan veprat e shkrimtarëve, si Sigmund Freud dhe T. S. Eliot.


Woolf filloi të botojë edhe shkrimet e veta, duke filluar me romanin *Udhëtim për matanë*, në vitin 1915. Megjithatë, vërtet e famshme u bë me romanin e katërt, *Zonja Dalloway*. I botuar në vitin 1925, ky roman trajtoi tema moderniste, si feminizmi, sëmundja mendore dhe homoseksualiteti.


Woolf-i më pas botoi romane të tjera të rëndësishme dhe të njohura, si *Udha për te fari* dhe *Orlando*, si dhe esetë feministe, *Një dhomë më vete* dhe *Tri monedha ari*. Të gjitha këto vepra i sollën suksesin dhe vlerësimin nga kritika si shkrimtare e shquar e ndryshimeve rrënjësore letrare. Por, pas disa përpjekjesh të dështuara për vetëvrasje, ishte më se e qartë se gjendja shëndetësore e Woolf-it nuk ishte e mirë.

ÇFARË E SHKAKTOI VETËVRASJEN E VIRGINIA WOOLF-IT?

Virginia Woolf-i ka thënë: “Të rritesh, do të thotë të humbësh disa iluzione, në mënyrë që të krijosh iluzione të tjera.” Ajo humbi shumë nga iluzionet e saj kur ishte fëmijë për shkak të disa traumave. E para nga këto ndodhi kur vëllezërit nga nëna, me martesën e parë, George dhe Gerald Duckworth, filluan të abuzojnë seksualisht me të. Në esetë personale Woolf-i zbuloi se abuzimi filloi që kur ishte gjashtë vjeçe deri në moshën 23-vjeçare, kur u largua nga ajo shtëpi për të mos jetuar më me familjen. Ndërsa ky abuzim seksual ka të ngjarë të ketë shkaktuar shumë nga problemet me sëmundjen mendore, vdekja e nënës në vitin 1895 u duk se i forcoi ato. Menjëherë pas kësaj, në moshën 13-vjeçare, Woolf-i pati çrregullimet e para mendore.

Gjatë viteve pas vdekjes së nënës ajo pësoi disa trauma me radhë. Motra nga nëna, Stela, ndërroi jetë dy vjet më vonë dhe në vitin 1904 babai i vdiq





nga kanceri në stomak. Shumë shpejt pas këtyre humbjeve Woolf-i nisi të kurohej, megjithëse për një kohë të shkurtër.

Edhe pas suksesit në letërsi dhe martesës së lumtur me Leonardin, Woolf-i vazhdoi të përballej me depresionin dhe sëmundjen mendore. Bëri disa përpjekje për vetëvrasje dhe vuajti nga halucinacionet, si dhe nga periudha manie. Provoi trajtime të ndryshme psikiatrike, por për shkak se hulumtimi i shëndetit mendor ishte në hapat e parë në atë kohë, ato patën vetëm rezultate negative. Një nga këto trajtime përfshinte edhe heqjen e disa dhëmbëve, një teori e zakonshme mjekësore në vitet 1920 që e shoqëronte sëmundjen mendore me infeksionet dentare.

LETRA E VETËVRASJES DHE ÇASTET E FUNDIT

Në mëngjesin e 28 marsit 1941 Leonard Woolf-i e dinte se diçka nuk ishte në rregull me bashkëshorten e tij prej 29 vjetësh. Pasi foli me të në studion jashtë shtëpisë në Sussex, e këshilloi të hynte brenda dhe të pushonte. Kjo ishte hera e fundit që Leonardi e pa gruan të gjallë.

Pasi Leonardi shkoi në zyrë, Woolf-i veshi pallton dhe çizmet me qafë, doli nga porta e përparme dhe u nis drejt lumit Ouse pranë shtëpisë së tyre. Kur Leonardi u ngjiti lart për të kontrolluar disa orë më vonë, gjeti dy letra para vetëvrasjes të lëna nga bashkëshortja. Njëra i drejtohej atij dhe tjetra motrës, Vanesa-s.

Në shënimin e lënë për të shoqin shkruhej: "I shtrenjti im, jam e sigurt se po çmendem përsëri. Ndiej se s'mund ta përballojmë edhe një periudhë tjetër me këtë përvojë të tmerrshme. Kësaj here s'do ta marr dot veten. Filloj të dëgjoj zëra dhe s'mund të përqendrohem. Kështu po bëj atë që duket gjëja më e mirë për të bërë."

Më tej në letrën e vetëvrasjes lexojmë: "Ajo që dua të them, është se gjithë lumturinë e jetës sime e kam pasur falë teje. Ke qenë përherë i durueshëm me mua dhe jashtëzakonisht i mirë. Po e them që ta dinë të gjithë. Po të kishte njeri që do të mund të më kishte shpëtuar, do të ishte ti. Gjithçka është zhdukur brenda meje, por jo siguria e mirësisë sate. S'mendoj se dy njerëz mund ishin më të lumtur sesa ishim ne."

I tronditur pasi lexoi letrën e vetëvrasjes, Leonardi kontrolloi rreth e rrotull. Shumë shpejt gjeti gjurmët e saj dhe bastunin në bregun e lumit, por uji tashmë ia kishte zhdukur trupin. Do të gjendej tri javë më vonë, pasi ujërat ta nxirrnin në breg të Southease-it, Angli. Kur u njoftua vdekja e Virginia Woolf-it, T. S. Elioti shkroi se ky ishte "fundi i një bote".

TRASHËGIMIA E PËRHERSHME E VDEKJES SË VIRGINIA WOOLF-IT

Pas vdekjes, trupi iu dogj dhe hiri u shpërnda nën dy vidha, me emrat "Virginia" dhe "Leonard", në oborrin e shtëpisë së çiftit. Leonardi kishte vënë aty një gur ku ishin gdhendur rreshtat e fundit nga romani i saj *Dallgët*: "Vërvitem drejt teje, e pamposhtur, e paepur, O Vdekje! Dallgët u përplasën në breg." La një roman dhe autobiografinë e papërfunduar. Letra e vetëvrasjes do të ishte ajo çfarë shkroi për herë të fundit.

Megjithatë, emri dhe kujtimi i Woolf-it vijnë të jetojnë. Romanet i janë kthyer në romane të

dashura klasike, ndërsa esetë në ikonë moderne feministe. Ajo, madje, u bë e pavdekshme në romanin fitues të çmimit "Pulitzer", *Orët* e Michael Cunningham-it, me Nicole Kidman si aktore në filmin që mbështetet te ky libër.

Përpos kësaj, vdekja e Virginia Woolf-it frymëzoi një ekip studiuesish për të krijuar një aplikacion i cili parashikon prirjet për vetëvrasje të një personi mbështetur në atë që shkruan. Duke studiuar ditarin e Woolf-it, të mbajtur gjatë gjithë jetës, si dhe letrat personale, ekipi shpreson të krijojë një softuer që mund të analizojë tekste, postën elektronike dhe postimet në mediat sociale të pacientëve në rrezik. Kur aplikacioni identifikon një ndryshim negativ në shkrimet e pacientit, menjëherë paralajmëron një kujdestar për të ndërhyrë në kohë.

Në këtë mënyrë, Virginia Woolf-i la pas një trashëgimi që është shumë më e madhe se jeta apo vdekja e saj. Diku ka shkruar: "Kur mendon për gjëra si yjet, vogëlimat tona s'duket të kenë edhe aq rëndësi apo jo?"

Përktheu: Granit Zela



AUTORI I "MENDO DHE PASUROHU"

NAPOLEON HILL

SHKALLA

MAGJIKE

drejt

SUKSESIT

Një botim zyrtar i
FONDACIONIT
NAPOLEON HILL

Minerva